



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39 regjistër (JR)  
Datë 21.07.2021

Nr. 58 i vendimit  
Datë 14.11.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 14.11.2024, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 39/2021 (JR), datë 21.07.2021, që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 378, datë 30.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, 33/1, 41, 42 dhe 179/b, paragrafi 2 i Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6, 13, 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 35-40 dhe 45-47.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të dorëzuara në Kolegji, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 378, datë 30.04.2021 dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup> dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
  - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
  - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
  - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim

<sup>1</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 25.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë vetting në rubrikën përkatëse.

<sup>3</sup> Referuar “Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri (Kaso)” të DSIK-së nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. {\*\*\*}, datë 30.03.2021.

<sup>4</sup> Referuar procesverbalit të datës 24.01.2017 të zyrës së protokoll-arkivit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, ka dorëzuar pranë këtij institucioni formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës nr. 4 të ligjit nr. 84/2016, më datë 24.01.2017.

që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016<sup>5</sup>.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, me vendimin nr. 378, datë 30.04.2021, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
  - Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri: (i) nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) Subjekti karakterizohet nga mosdeklarimi në mënyrë të përsëritur të burimeve të krijimit të pasurive të saj; (iii) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016; (iv) Ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*
  - Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*
  - Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provuan indicie apo elemente që cenojnë figurën e gjyqtares Evjeni Sinojmeri dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të*

---

<sup>5</sup> Shih raportin e KLGj-së “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Evjeni Sinojmeri për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016” me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2019, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.05.2019.

pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme për sa i përket periudhës së rivlerësimit.

▪ Në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, arriti në konkluzionin se: Subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, konkretisht nuk provoi burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive të deklaruar në deklaratën vetting, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 378, datë 30.04.2021, duke e kundërshtuar atë në drejtim të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit, si dhe vlerësimit të kryer nga ky i fundit kryesisht për kriterin e pasurisë, por edhe atë etiko-profesional.
10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, ankimin e saj e shoqëroi me disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Bazuar në nenet 63, pika 1, 65, 66, pika 1, shkronjat “b” e “c” dhe në nenin 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, të vendosë:
  - Gjykimin në seancë gjyqësore publike të çështjes nr. 378 vendimi, datë 30.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Evjeni Sinojmeri.
  - Marrjen e provave të reja bashkëngjitur këtij ankimi, si dhe atyre që do të siguroj përpara se çështja të gjykohet në seancë publike.
  - Prishjen e vendimit nr. 378, datë 30.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si vendim i pavlefshëm, për shkak të zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit/ose – Ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Evjeni Sinojmeri.
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
  - 11.1. Është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuadër të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, pasi nga Komisioni janë shkelur një pjesë e konsiderueshme e të drejtave kushtetuese të interpretuara edhe nga Gjykata Kushtetuese<sup>6</sup>.

<sup>6</sup> Subjekti ka referuar një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, si vendimet nr. 39, datë 29.12.2005, nr. 30, datë 28.12.2006, nr. 22, datë 07.10.2008, nr. 15, datë 08.06.2009, nr. 15, datë 03.05.2011.

11.2. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit kalimtar, është i pabazuar.

11.3. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje disiplinore në vijimësi referuar shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, si pasojë e mosparaqitjes në punë pa shkaqe të arsyeshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, është i pabazuar dhe, me përfundimet e arritura, Komisioni ka tejkeluar rrethin e kompetencave që i njeh ligji, si i vetmi institucion kompetent për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. Konkluzioni i Komisionit për fshehje të deklarimit të apartamentit me sipërfaqe 59,80 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Rrugën {\*\*\*}, Tiranë, është i pabazuar dhe analiza financiare për periudhën 1985-2000, me balancë negative, është e gabuar.

12.2. Konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, burimin e krijimit për apartamentin e banimit me sipërfaqe 103,4 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 2004, me vendndodhje në Rrugën {\*\*\*}, është i pavend për sa kohë subjekti ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie me kredi bankare dhe vetë Komisioni, në vendim, analizën e tij lidhur me këtë pasuri e ka bazuar në verifikimin e këtij burimi.

12.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 66,2 m<sup>2</sup>, objekt i kontratës së sipërmarrjes të lidhur në vitin 2004, me vlerë 28.000 euro, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, duke pretenduar se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për ta blerë këtë pasuri nga vëllai i saj në vitin 2009 dhe jo në vitin 2004.

12.4. Konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen në vitin 2004, të pasurisë së paluajtshme të llojit “garazh” me sipërfaqe 19,1 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “{\*\*\*}”, është i gabuar.

12.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare për pagesën e këstit të parë dhe kohës kur janë kryer pagesat e kësteve të tjera lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 128 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “{\*\*\*}”, objekt i kontratës së sipërmarrjes të lidhur në vitin 2004.

12.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit se jo e gjithë vlera prej 3.900.000 lekësh, që vjen nga shitja e truallit + ndërtim në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, i takon subjektit të rivlerësimit, duke i zbritur kësaj kundërvlerën e një sipërfaqeje prej 34 m<sup>2</sup> të truallit që ka pasur në pronësi babai i subjektit të rivlerësimit, si dhe ndërtimit të kryer mbi të.

12.7. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë arsyetimin e Komisionit se për pasurinë e luajtshme të llojit automjet të tipit “Ford Focus”, e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 si e blerë në vitin 2010, nuk është provuar burimi i krijimit pasi nuk janë paraqitur dokumente që të provojnë punësimin me kohë të pjesshme të djemve të subjektit, duke pretenduar se është ndodhur në kushtet e pamundësisë objektive.

12.8. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar investimin e kryer nga djali i saj E. S. në obligacionet e thesarit, në shumën e 9.600.000 lekëve.

12.9. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve në shumën prej 40.000 USD, të cilat ia ka dërguar djalit S. S. në SHBA.

12.10. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se lidhur me justifikimin e ligjshmërisë së shumës prej 15.000 USD, të deklaruar si të dhuruar djalit të subjektit të rivlerësimit nga gjyshërit me rastin e largimit në SHBA, nuk ka paraqitur prova, duke pretenduar se ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive.

13. Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

13.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të panevojshëm dhe kontradiktor arsyetimin e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të etikës, në lidhje me trajtimin e çështjes së mosparaqitjes së saj në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që nga data 01.04.2020.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Evjeni Sinojmeri, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>7</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>7</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 378, datë 30.04.2021, për rivlerësimin e subjektit, znj. Evjeni Sinojmeri, i është njoftuar kësaj të fundit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.06.2021, konfirmuar marrja dijeni nga z. E. S. (djali i subjektit të rivlerësimit, identifikuar sipas letërnjoftimit me nr. {\*\*\*}) më datë 18.06.2021, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 378, datë 30.04.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
17. Pas regjistrimit në Kolegj të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit nr. 39/2021 (JR), datë 21.07.2021, që i përket ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, kjo e fundit, në mbështetje të pretendimeve të ngritura në ankim për gjykim të çështjes në seancë gjyqësore publike, së bashku me parashtrimet me shkrim ndaj shkaqeve të ankimit, më datë 24.10.2024, depozitoi në Kolegj edhe një kërkesë për marrjen në cilësinë e provave të reja në proces dhe shqyrtimin nga Kolegji, të disa akteve shpresore bashkëlidhur saj.
18. Trupi gjykues konstatoi fillimisht se në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të depozituara më 24.10.2024, në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, znj. Evjeni Sinojmeri parashtronte për herë të parë në Kolegj:
  - (i) pretendime për mospërfshirjen në analizën e Komisionit të të ardhurave nga mësimdhënia e subjektit të rivlerësimit në Universitetin Evropian të Tiranës në vlerën e 70.000 lekëve;
  - (ii) pretendime për përllogaritje të gabuar të likuiditeteve të deklaruara si kursime të familjes në DIPPV-në e vitit 2007;
  - (iii) pretendime për përllogaritje të gabuar të shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, në vlerën e 943.872 lekëve;
  - (iv) pretendime për përllogaritje më të larta të shpenzimeve të udhëtimit në tërësi, për pjesën më të madhe të viteve të analizës financiare;
  - (v) pretendime për përllogaritje të gabuar të pakësimeve të likuiditeteve në shumën 1.164.456 lekë, që i korrespondon vlerës së blerjes së automjetit “Ford Focus”;
  - (vi) pretendime lidhur me deklaratime të pasakta nga vetë subjekti i rivlerësimit të të ardhurave të realizuara dhe kursimeve në gjendje *cash* në DIPPV-në e vitit 2011;
  - (vii) pretendime për mosmarrjen parasysh nga Komisioni të të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit “Rover”, në vlerën e 50.000 lekëve, sipas kontratës së shitjes në vitin 2011;
  - (viii) pretendime për mospërllogaritje të të ardhurave nga mësimdhënia e subjektit të rivlerësimit në Universitetin Amerikan të Tiranës në vlerën e 329.300 lekëve;

---

*depozituar në Komision më datë 01.07.2021, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {\*\*\*}, datë 01.07.2021, që rezulton të jetë dita e 13-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti e ka dorëzuar ankimin në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*

(ix) problematika në deklarin nga subjekti i të ardhurave nga interesat bankarë të bonove të thesarit për disa vite;

(x) pretendime për përlllogaritje të gabuar nga ana e Komisionit të shpenzimeve të mobilimit.

19. Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se ato janë paraqitur në Kolegj në tejkalim të ankimit dhe në kapërcim të afatit ligjor për kundërshtimin e vendimit të Komisionit objekt gjykimi dhe, rrjedhimisht, referuar nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, vlerësohen të kenë rënë në dekadencë. Si të tilla, ato nuk u morën në shqyrtim nga trupi gjykues gjatë shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 378, datë 30.04.2021.
20. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, për marrjen e provave të reja, referuar këtu akteve shkresore që subjekti i kishte bashkëlidhur ankimit dhe atyre të depozituara në Kolegj më datë 24.10.2024, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për marrjen e provave, pasi nga analiza e kryer në kuadër të parashikimeve të nenit 47, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” e “d” të ligjit nr. 84/2016, u arrit në përfundimin se nuk plotësohen kërkesat e dispozitave procedurale të sipërcituara për pranueshmërinë e këtyre akteve në cilësinë e provave të reja në proces.
21. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së kryer lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë publike, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni*

22. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuadër të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, duke qenë se, sipas saj, nga ana e Komisionit i janë shkelur një pjesë e konsiderueshme e të drejtave të garantuara nga dispozitat e sipërcituara, të interpretuara edhe nga Gjykata Kushtetuese<sup>8</sup>, duke iu referuar këtu: (i) parimit të kontradiktoritetit, (ii) të drejtës për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u përfaqësuar në proces, si dhe (iii) parimit të drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit në vendimmarrje.*
23. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se: (i) me përfundimin në mënyrë të njëanshme të raportit mbi rezultatet e hetimit nga Komisioni, është shkelur parimi i

<sup>8</sup> *Subjekti ka referuar një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese si vendimet nr. 39, datë 29.12.2005, nr. 30, datë 28.12.2006, nr. 22, datë 07.10.2008, nr. 15, datë 08.06.2009, nr. 15, datë 03.05.2011.*

kontradiktoritetit, duke mos i dhënë praktikisht mundësinë të paraqesë prova; (ii) nuk i është dhënë koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndonëse Komisioni i ka bërë të ditur të drejtën për të caktuar një përfaqësues, i cili të njihet me dosjen dhe ta përfaqësojë atë në seancën dëgjimore, sipas saj, që përfaqësuesi të mund të realizonte një mbrojtje efektive (jo formale) ishte e nevojshme të pajisej me dokumentacion provues, si dhe të merrte prej subjektit të gjitha shpjegimet e nevojshme, duke qenë se ky proces ishte posaçërisht i lidhur me të. Sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, ka qenë e pamundur të realizohej për shkak se ajo nuk mund të siguronte dokumentacionin e nevojshëm nga vendi ku ndodhej (Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga ana e Komisionit, është shkelur parimi i drejtësisë dhe paanësisë i parashikuar në nenin 13 të Kodit të Procedurës Administrative. Subjekti parashtroi se koordinimi i veprimeve të Komisionit me KLGj-në, pa treguar interes për jetën dhe shëndetin e saj, provon se Komisioni ka qenë i njëanshëm dhe paragjykues ndaj saj. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka vlerësuar dhe nuk u ka dhënë rëndësinë e duhur kushteve në të cilat ndodhej ajo, por duke vepruar me shpejtësi në përfundimin e procedurës ka shkelur parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, sipas neneve 12 dhe 14 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se Komisioni ka mbyllur hetimin administrativ dhe ka zhvilluar seancën dëgjimore në mënyrë të njëanshme, duke mos i dhënë mundësinë të paraqesë prova apo të japë shpjegimet përkatëse për pyetjet që janë ngritur gjatë hetimit administrativ.

24. Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, pasi verifikoi procedurat e ndjekura në Komision lidhur me zhvillimin e hetimit administrativ për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, trupi gjykues vlerësoi se ky shkak ankimi është i pabazuar në fakte. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se me përfundimin në mënyrë të njëanshme të raportit mbi rezultatet e hetimit nga Komisioni është shkelur parimi i kontradiktoritetit, duke mos i dhënë asaj mundësinë të paraqesë prova, dhe as kohën dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes, u çmuan nga trupi gjykues të pabazuara, për sa kohë nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton se ky i fundit në kuadër të komunikimeve të zhvilluara për efekt të plotësimit të pyetësorëve të ndryshëm ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit në çdo rast, përveç dhënies së shpjegimeve lidhur me çështje konkrete, edhe përcjelljen e dokumentacionit mbështetës në funksion të sa më sipër. Trupi gjykues vëren gjithashtu se edhe në përfundim të hetimit paraprak, sipas vendimit të Komisionit nr. 2, datë 07.04.2021, ky i fundit teksa i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjet e hetimit të zhvilluar e ka ftuar atë për t'u njohur me aktet e administruara nga Komisioni, duke i njoftuar, në të njëjtën kohë, edhe të drejtat që ajo gëzonte në kuadër të kësaj procedure hetimi administrativ, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, përfshirë edhe atë të marrjes së provave ose thirrjen e dëshmitarëve. Trupi gjykues vlerëson se në këtë mënyrë Komisioni ka përmbushur detyrimet ligjore për dhënien e garancive për realizimin e një procesi të rregullt ligjor, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të njihet me gjetjet e Komisionit, të dëgjohej e mbrohej lidhur me to, nëpërmjet dhënies së shpjegimeve dhe marrjes së provave, si dhe marrjes pjesë në seancën dëgjimore për këtë qëllim.
25. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se sjellja e Komisionit duke i bërë të ditur të drejtën për të caktuar një përfaqësues, i cili të njihet me dosjen dhe ta përfaqësojë atë në seancën dëgjimore, nuk i garantonte asaj një mbrojtje efektive, pasi për këtë qëllim ishte e nevojshme pajisja me

dokumentacion provues dhe marrja prej subjektit e të gjithë shpjegimeve të nevojshme, gjë që mundësohej vetëm me ardhjen e saj në Shqipëri, u vlerësuan nga trupi gjykues si pretendime të paprovuara, sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk tregoi asnjë përpjekje të saj në drejtim të çuarjes përpara të procesit të rivlerësimit, nëpërmjet caktimit të një përfaqësuesi ligjor dhe, rrjedhimisht, as të pamundësisë për t'u mbrojtur në mënyrë efektive për shkak të pamundësisë për të qenë prezente, pavarësisht përfaqësimit të interesave të saj ligjorë nga një përfaqësues i caktuar me prokurë. Në këto kushte, në vlerësim të trupit gjykues, shkak i ankimit për cenim të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor, gjendet i pabazuar në fakte.

26. Në kuadër të këtij shkak i ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit të dorëzuar në Kolegj në datën 24.10.2024, me objekt “Kërkoj marrjen dhe pranimin e provave”, si dhe aktet bashkëlidhur saj. Subjekti i rivlerësimit këtë kërkesë e kishte bazuar në nenet 45, 49, 52 dhe 65 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47 e 81 të Kodit të Procedurave Administrative.
27. Në kërkesën e saj, si më sipër cituar, subjekti pretendoi se procesi i rivlerësimit të saj është zhvilluar në shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe është përfunduar nga Komisioni pa pasur mundësi të paraqitje dhe të dëgjohej në seancën dëgjimore, si dhe në pamundësi për të siguruar provat dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni për shkaqe objektive, pa fajin e saj. Në këto kushte referuar nenit 47 të Kodit të Procedurave Administrative ajo i kërkoi Kolegjit që të pranonte dhe të administronte në cilësinë e provës, fillimisht dokumentacionin që vërteton sipas saj proceduralisht pamundësinë e saj objektive për të paraqitur prova, si gjatë gjykimit në Komision ashtu edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, gjithashtu edhe dokumentacionin që i referohet sipas saj themelit të pretendimeve të ngritura në ankimin e saj lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke potencuar se në këtë mënyrë i është cenuar e drejta e saj për proces të rregullt ligjor.
28. Në shqyrtimin e kësaj kërkesë, trupi gjykues konstatoi fillimisht se dispozita së cilës i referohej subjekti i rivlerësimit, neni 47 i Kodit të Procedurës Administrative, “E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime”<sup>9</sup>, përcakton të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procedurës administrative të zhvilluar në Komision, ndërkohë që, referuar nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj zhvillohet në përputhje me parashikimet e neneve 47, 48, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012.
29. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se kërkesa e subjektit të rivlerësimit duhet t'i nënshtrrohej zbatimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në kombinim me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit në ankim nuk mund të paraqesë fakte të reja dhe të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e saj nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Komision. Në analizën e tij lidhur me shqyrtimin e kërkesës për marrjen e provave të reja në proces trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>9</sup> Në nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet: “Të gjitha palët në çdo fazë të procedurës kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”.

30. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi fillimisht që aktet bashkëlidhur kërkesës së datës 24.10.2024 janë dorëzuar në Kolegj së bashku me parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, pas marrjes njoftim lidhur me caktimin e datës dhe orës së seancës gjyqësore për shqyrtimin e saj sipas shpalljes së këtij njoftimi nga kryesuesja e trupit gjykues më datë 18.10.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Në zbatim të kësaj dispozite subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe jo fakte të reja apo të kërkojë marrjen e provave të reja, për të cilat do duhej të kishte mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 47 të të njëjtit ligj, sipas të cilit vetëm kur provon se pa faj të saj nuk ka mundur të paraqesë gjatë procesit të zhvilluar në Komision fakte dhe prova të reja, të mund t'i paraqesë ato së bashku me ankimin, brenda afateve ligjore të përcaktuara për këtë qëllim.
31. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se kërkesa e datës 24.10.2024 përmbante akte të cilat jo vetëm nuk ishin përfshirë në ankimin e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, por as ishin referuar në ankim si akte të cilat në pamundësi për t'u dorëzuar brenda afatit të ankimit priteshin të dorëzoheshin nga subjekti i rivlerësimit në vijim. Kërkimi i subjektit në ankim: *Kërkoj marrjen e provave të reja bashkëlidhur këtij ankimi, si dhe atyre që do të siguroj përpara se çështja të gjykohet në seancë publike*, pa treguar për trupin gjykues as për çfarë provash bëhet fjalë, as përpjekjet për t'i siguruar ato brenda afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni procedural në fuqi, u vlerësua nga trupi gjykues si një kërkim në tejkalim të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.
32. Përveç sa më sipër, trupi gjykues, nga një shqyrtim më i hollësishëm i akteve të depozituara në Kolegj më datë 24.10.2024, vërejti edhe sa më poshtë.
- 32.1. Lidhur me aktet e “Listës së provave të reja për pjesën procedurale” përveç 2 akteve të nënshkuara përkatësisht nga z. A. D. dhe z. K. S., të cilat i referoheshin të dhënave lidhur me raportimin mbi progresin e pacientit pas ndërhyrjes kirurgjikale të datës 14.12.2021, pjesa tjetër e dokumentacionit konsistonte në akte të cilat kanë qenë në posedim të subjektit të rivlerësimit, minimalisht që në momentin e ushtrimit të ankimit ndaj vendimit të Komisionit dhe, si të tilla, nuk kishin asnjë pengesë për t'u përfshirë në aktet që kanë shoqëruar ankimin e subjektit dhe jo të depozitoheshin në Kolegj rreth 3 vite e disa muaj më vonë, pa asnjë justifikim të arsyeshëm lidhur me tejkalimin e parashikimeve të neneve 47 dhe 49 të ligjit nr. 49/2012.
- 32.2. Lidhur me grupin e akteve pjesë e “Listës së provave të reja për themelin”, trupi gjykues konstatoi se:
- (i) Sa u takon akteve të lëshuara nga institucionet shtetërore lidhur me justifikimin e udhëtimeve të punës për subjektin e rivlerësimit, bashkëshortin dhe djalin e saj, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë për t'i siguruar këto akte nëpërmjet komunikimeve shkresore me këto institucione dhe për t'i depozituar ato në vijim pranë Komisionit, gjatë periudhës së hetimit administrativ. I njëjti qëndrim vlen edhe për aktet private, deklarime të personave të tretë të afërm apo familjarë të subjektit të rivlerësimit lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, akte këto për të cilat nuk vlerësohet se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka përbërë pengesë objektive në sigurimin e tyre. Po ashtu, edhe aktet të cilat u referohen komunikimeve të subjektit të rivlerësimit me organizma ndërkombëtarë

(organizatorë të aktiviteteve, si p.sh., IRZ etj.) konstatohen të jenë komunikime të kryera në postën elektronike të znj. Sinojmeri, e cila mund të aksesohet në çdo kohë prej saj, pavarësisht vendndodhjes së kësaj të fundit.

(ii) Lidhur me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë nr. {\*\*\*} prot., datë 24.11.2022, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit kërkoi të provojë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i noterisë për periudhën kohore 1996-2000, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë për depozitim të këtij akti në përputhje me parashikimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, që në kohën kur zhvillohej procesi i rivlerësimit në Komision, për sa kohë ky akt është siguruar nëpërmjet një komunikimi shkresor dhe mosprezenca fizike e subjektit të rivlerësimit në Shqipëri gjatë periudhës së hetimit administrativ nuk duket të kishte ndonjë ndikim në sigurimin e tij. Për më tepër, ky komunikim shkresor vjen si një kërkesë e subjektit të rivlerësimit e datës 14.11.2022<sup>10</sup>, me të cilën kjo e fundit kërkon rreth 6 vite më vonë sqarim lidhur me përgjigjen e marrë nga i njëjti institucion, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2016, me të cilën është informuar se nga verifikimet e kryera në sistemin e-c@ts, nuk disponohen të dhëna lidhur me të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të lirë të noterit në Rrethin e Gjirokastrës, për periudhën 1996-2000. Mosveprimi i subjektit për rreth 6 vite lidhur me sigurimin e dokumentacionit justifikues lidhur me të ardhurat e pretenduara nga ushtrimi i këtij aktiviteti, u vlerësua nga trupi gjykues i pajustificueshëm.

33. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, është njoftuar nga Komisioni mbi nisjen e procesit të rivlerësimit kalimtar që më datë 31.01.2019, 1 vit përpara se të deklarohet gjendja e pandemisë Covid-19. Nga kjo periudhë deri në datën 23 mars 2020, kur konstatohet të jenë ndërprerë për shkak të pandemisë<sup>11</sup>, fluturimet e shoqërisë ajrore Lufthansa (shoqëria pranë së cilës subjekti pretendonte se kishte prerë biletën e kthimit për në Shqipëri), subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë problematikë shëndetësore të konstatuar në ekzaminime të kryera, referuar akteve të përcjella në cilësinë e provave të reja. Në komunikimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, më datë 20.10.2020, subjekti i rivlerësimit pohon rifillimin e fluturimeve, por pretendon pamundësinë e saj për të fluturuar për shkak të riskut të infektimit për shkak edhe të sëmundjeve shoqëruese, si: hipertensioni, astma dhe gurët në veshka, ndërkohë që ndërhyrja kirurgjikale në shtyllën kurrizore (hernie e disqeve), e cila vlerësohet objektivisht si një pengesë reale për pamundësinë e udhëtimit, është kryer më datë 14.05.2021, rreth 15 ditë pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt ankimi.
34. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues çmoi se aktet e përcjella në Kolegj dhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit për marrjen e tyre në cilësinë e provave të reja jo vetëm nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, por edhe në këndvështrim të vlerës së tyre provuese u çmuan pa efekt në vlerësimin e shkakut të ankimit për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor duke qenë se pamundësia e saj për të udhëtuar nga Shtetet e Bashkuara drejt Shqipërisë nuk u provua të kishte prodhuar pasojën e pamundësisë objektive për të siguruar

<sup>10</sup> Protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, më datë 16.11.2022, cituar dhe në shkresën e kësaj të fundit "Kthim përgjigje" me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.11.2022.

<sup>11</sup> Shih: <https://www.statista.com/statistics/1111989/flights-cancelled-airlines-worldwide-covid-19/>.

dokumentacionin justifikues të nevojshëm për çuarjen përpara të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe as të cenimit të së drejtës së saj për proces të rregullt ligjor.

35. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se nuk ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit kalimtar. Në mbështetje të këtij shkak ankimi subjekti i rivlerësimit pretendoi se:*

35.1. Nuk ka asnjë dijeni lidhur me *e-mail*-in e pretenduar si të dërguar nga Komisioni në datën 19.10.2020, pasi në postën e saj elektronike nuk ka një komunikim të tillë. Subjekti pretendoi se nuk kishte asnjë arsye që të mos i përgjigjej pikërisht vetëm këtij komunikimi, ndërkohë që nuk ka shfaqur në asnjë rast refuzim për të komunikuar me Komisionin. Gjithashtu sipas saj Komisioni përpara se të ngrinte një pretendim të tillë duhet të sigurohej dhe të vërtetonte me të gjitha mjetet që dispononte se ky *e-mail* kishte mbërritur në postën e saj elektronike.

35.2. Lidhur me përgjigjet e kthjera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, në dy raste të tjera të komunikimit me postë elektronike, në të cilat ajo ka bërë me dije pamundësinë e saj për t'u paraqitur para institucioneve shtetërore për t'u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për shkak se ndodhej jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ato nuk mund të vlerësohen si refuzime për t'u përgjigjur. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në mungesën e saj si dhe të familjes së saj ka qenë e pamundur që një përfaqësues i saj me prokurë të mund të plotësonte këtë detyrë, e cila sipas saj kërkonte njohuri për situatën, kohë e përkushtim, pasi bëhej fjalë për dokumente që i përkisnin një shtrirjeje kohore tepër të gjatë (mbi 30 vite).

36. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në lidhje me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, ndaj procesit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se kjo e fundit nuk u është përgjigjur kërkesave të Komisionit, duke mos iu dhënë përgjigje shteruese pyetësorëve dhe duke mos bashkëpunuar në procesin e hetimit administrativ.

37. Pasi verifikoi të gjithë pyetësorët e dërguar nga Komisioni, si dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet dhënies ose jo të përgjigjeve ndaj këtyre pyetësorëve të përcjellë nëpërmjet postës elektronike, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për mosbashkëpunim të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e procesit të rivlerësimit është i bazuar, sa kohë rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte përmbushur kërkesat e Komisionit për të dhënë shpjegime dhe dokumentacion justifikues lidhur me pyetjet e adresuara. Trupi gjykues vlerësoi se, pavarësisht faktit që pamundësia fizike për t'u kthyer në Shqipëri në periudhën e pandemisë, mund të ketë qenë për shkaqe objektive, ajo nuk mund të vlerësohet si një shkak i përligjur për të ndërprerë komunikimin me Komisionin dhe, rrjedhimisht, për të kërkuar pezullimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri. Trupi gjykues evidenton në mënyrë të posaçme përgjigjet e subjektit në komunikimet e datave 11.03.2021 dhe 04.06.2021, përkatësisht: [...] *Në këto kushte, edhe pse për secilën nga pyetjet që më janë drejtuar e kam një përgjigje, e kam të pamundur sigurimin e dokumentacionit. Rezervoj të drejtën që përgjigjet, së bashku me dokumentacionin mbështetës, t'i kthej menjëherë sapo të jem kthyer në Shqipëri. [...]* Ju bëj me dije se me gjithë përpjekjet e mia për të përfunduar në kohë dhe me saktësi detyrën e ngarkuar prej jush, e kam të pamundur të kthej një përgjigje. Kjo për shkak se mbas përfundimit të një periudhe ndërprerjeje nga ushtrimi i detyrës me leje nga ish-KLD-ja, vazhdoj të mbetem

*jashtë vendit, e bllokuar nga situata e pandemisë. [...] Në këtë situatë pamundësie objektive, do kërkoja mirëkuptimin tuaj për të vazhduar komunikimin në një moment të mëvonshëm, kur të jem kthyer në Shqipëri. Një sjellje e tillë e subjektit të rivlerësimit, në mungesë edhe të të provuarit të përpjekjeve të kësaj të fundit për të përmbushur kërkesat e Komisionit nëpërmjet caktimit të një përfaqësuesi ligjor, në vlerësimin e trupit gjykues, me të drejtë, është çmuar nga ana e Komisionit si mungesë e bashkëpunimit të subjektit në kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, i cili përbënte një detyrim kushtetues.*

38. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit se ajo ka kryer shkelje disiplinore në vijimësi, referuar shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, si pasojë e mosparaqitjes së saj në punë pa shkaqe të arsyeshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.*
39. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi se Komisioni ka arritur në këtë konkluzion edhe pse ishte në dijeni të gjyqimit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit lidhur me këtë çështje, gjykim i cili kishte përfunduar me dhënien e vendimit nr. 11, datë 02.02.2021, në favor të subjektit, duke vendosur shfuqizimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe detyrimin e tij për të vijuar shqyrtimin e kërkesës së gjyqtarës Evjeni Sinojmeri [...]. Këtë vendim, së bashku me disa akte që provojnë gjendjen shëndetësore të subjektit të rivlerësimit në këtë periudhë, kjo e fundit ia ka bashkëlidhur ankimit, pa u shprehur në mënyrë të veçantë lidhur me vlerën e tyre provuese. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, me përfundimet e arritura, Komisioni ka tejkaluar rrethin e kompetencave që i njeh ligji, si i vetmi institucion kompetent për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Komisioni, sipas saj, duke dashur të bëjë edhe një herë vlerësimin e provave në drejtim të mosparaqitjes së saj në punë, në njëfarë mënyre ka pretenduar të bëjë rolin e gjykatës administrative, duke mos pasur parasysh parashikimet e nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera [...].*
40. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni, duke vepruar në këtë mënyrë, në dijeni edhe të faktit se vetë KLGj-ja kishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ nr. 11, datë 02.02.2021, kishte shkelur parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, i cili në paragrafin 3 të nenit 36 parashikon se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”. Sipas subjektit të rivlerësimit Komisioni ka gabuar pasi i ka njoftuar raportin e hetimit administrativ në datën 08.04.2021, pa pritur të ezaurohej afati i parashikuar nga ligji për kundërshtimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.03.2021 të KLGj-së (vendimi i dytë) duke nxituar ta merrte atë në konsideratë dhe mbi bazën e tij të vlerësonte se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje disiplinore.
41. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se sa më sipër referuar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me trajtimin nga Komisioni të mosparaqitjes në punë nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë përtej lejes (2-vjeçare) pa të drejtë rroge sipas vendimit përkatës të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka qenë një gjetje fillestare e Komisionit, e cila është bërë pjesë e rezultateve të hetimit administrativ, por nuk rezulton të ketë prodhuar pasojë juridike për

subjektin në kuadër të procesit të rivlerësimit të saj. Sa më sipër, bazohet në konstatimin se lidhur me këtë gjetje, Komisioni në vendimin e tij ka konkluduar se vlerësimi i shkeljes disiplinore lidhur me etikën, e ndodhur pas periudhës së rivlerësimit, është kompetencë vlerësimi e KLGj-së dhe jo e Komisionit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, nuk paraqesin relevancë në shqyrtimin e ankimit të saj për kundërshtimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe, rrjedhimisht, nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e tij. Po ashtu, edhe aktet e sipërcituara bashkëlidhur ankimit, nuk paraqesin relevancë në kontekst të sa më sipër dhe, si të tilla, u trajtuan nga trupi gjykues në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, duke mos u marrë në cilësinë e provave të reja në këtë proces.

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

42. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për fshehje të deklarimit të apartamentit me sipërfaqe 59,80 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 2012, në vlerën 26.855 USD, me vendndodhje në Rrugën {\*\*\*}, Tiranë dhe për analizë financiare me balancë negative për verifikimin e burimeve të ligjshme të krijimit të saj në periudhën 1985-2000, trupi gjykues konstatoi si vijon.
43. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit është në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, nuk u provuan të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
44. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, në ankimin e saj ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe ka pretenduar se nga ana e saj, nuk ka asnjë fshehje të deklarimit të apartamentit me sipërfaqe 59,80 m<sup>2</sup> në vitin 2003, pasi ky apartament është blerë në vitin 2012, si dhe se analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1985-2000, e cila ka rezultuar me balancë negative, është e gabuar. Në mbështetje të këtij shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, pretendoi se dy mandatpagesat e vitit 2000, të cilat figurojnë në emrin e bashkëshortit të saj, secila me vlerë 10.000 USD, të kryera në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nuk i përkasin këtij apartamenti, i cili, sipas saj, është blerë në vitin 2012, por atij të blerë nga babai i subjektit, z. H. K., në vitin 2000, i cili i është shitur në vijim në vitin 2004 subjektit të rivlerësimit, e cila e ka blerë me anë të kredisë bankare të lëvruar për këtë qëllim. Sipas subjektit të rivlerësimit, apartamenti me sip. 59,80 m<sup>2</sup> është blerë prej saj në vitin 2012 dhe pagesa është bërë tërësore me nënshkrimin e kontratës, dhe blerja në këtë vit është bërë për arsye zgjerimi, pasi është ngjitur me apartamentin e blerë në vitin 2004, ku dhe jeton subjekti që prej këtij viti. Sipas subjektit të rivlerësimit, deri në vitin 2012, ky apartament ka qenë në pronësi të shoqërisë ndërtuese. Ky fakt, sipas subjektit të rivlerësimit, vërtetohet nga faturat e energjisë elektrike të muajve nëntor e dhjetor të vitit 2011, të përcjella bashkëlidhur ankimit.

45. Subjekti pretendoi gjithashtu se edhe sikur vërtet 2 mandatpagesat e sipërpërmendura t'i përkisnin apartamentit objekt kontrolli, ajo i ka pasur të gjitha mundësitë për të paguar shumën 20.000 USD që përmendet në to. Në lidhje me rezultatin e analizës financiare të kryer nga Komisioni, subjekti pretendoi se përlllogaritjet e kryera në funksion të verifikimit të mundësisë financiare për blerjen e këtij apartamenti, përveçse nuk kanë qenë të nevojshme të bëheshin, pasi nuk bëhej fjalë për blerje nga ana e saj, janë edhe tërësisht të gabuara. Sipas subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 1985-2000, nuk janë përfshirë:
- (i) Të ardhurat nga paga e bashkëshortit të saj për vitet 1985-1992, si mësues në shkollën e mesme të përgjithshme “{\*\*\*}”, Gjirokastër, fakt ky, sipas subjektit, i provuar me dokumentacion, përkatësisht vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 17.08.2016, i lëshuar nga gjimnazi “{\*\*\*}”, Gjirokastër dhe vërtetimi nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2016, i Drejtorisë Arsimore Gjirokastër, që vërtetojnë se nuk disponojnë listëpagesa për këto periudha, por vetëm pas vitit 2007. Në kuadër të të provuarit të sa më sipër, subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur ankimit edhe një akt të titulluar “Akt verifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994”, i mbajtur në Arkivin Vendor Gjirokastër, me të cilin, sipas saj, shteti e ka njohur këtë periudhë pune të rregullt dhe e ka përfshirë në totalin e viteve të punës në kuadër të dokumentacionit për dhënien e pensionit të pleqërisë.
  - (ii) Të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në Gjermani në periudhën korrik 1992 - mars 1993. Subjekti, pasi shpjegon se ka dorëzuar dokumentacion për këtë qëllim, kundërshton konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen e këtyre të ardhurave si të paarsyetuar.
  - (iii) Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i saj si notere në periudhën shkurt 1996 – prill 2001, duke qenë se nga organet tatimore nuk ka pasur dokumente që të provojnë këto të ardhura, pavarësisht dokumentacionit të dorëzuar prej saj, ndër to edhe vërtetimi datë 23.01.2017, i lëshuar nga notere G. K.. Në kuadër të të provuarit të përfitimit të të ardhurave të deklaruara nga ky aktivitet i ushtruar, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë bashkëlidhur ankimit edhe një tjetër vërtetim të së njëjtës notere, sipas të cilit të ardhurat e pasqyruara në regjistrat ku janë evidentuar aktet dhe veprimet noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, kapin vlerën e 3.683.982 lekëve. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se pas një pune voluminoze që kërkonte shumë kohë, është bërë e mundur marrja e këtij vërtetimi në datën 21.06.2021.
46. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim dhe në parashtrimet me shkrim para Kolegjit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
47. Fillimisht, sa i takon shkakut të ankimit lidhur me deklarin e kryer ana e subjektit të rivlerësimit për pasurinë objekt kontrolli, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri, është bazuar vetëm në pamjaftueshmërinë e konstatuar të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj dhe, pavarësisht evidentimit të faktit që subjekti nuk ka deklaruar pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2000 në deklaratën për herë të parë, Komisioni nuk duket të ketë arritur në ndonjë konkluzion për fshehje apo mosdeklarim të kësaj pasurie. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se ky shkak i ankimit nuk ka objekt dhe rrjedhimisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim nuk paraqesin asnjë relevancë në lidhje me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli.

48. Sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit lidhur me analizën financiare të këtij të fundit, lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të kësaj pasurie, pasi verifikoi aktet e fashikullit të hetimit administrativ, trupi gjykues mori fillimisht në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesës së çmimit të kësaj pasurie në vitin 2012 dhe jo në vitin 2002, sikundër konkluduar nga Komisioni, moment ky i cili ka shërbyer edhe si faktor determinues i periudhës kohore për vlerësimin e burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e pagesave lidhur me çmimin e apartamentit.
49. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi se me kontratën e shitjes (pasuri e paluajtshme) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.01.2012, të lidhur para noteres M. D., shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e shitësit, i ka shitur subjektit të rivlerësimit pasurinë e paluajtshme të llojit apartament, të regjistruar në ZVRPP Tiranë në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, me nr. pasurie {\*\*\*}. Sipas parashikimit të kësaj kontrate: [...] çmimi i shitjes së apartamentit të përshkruar më sipër, është 26.855 USD. Kjo vlerë është likuiduar në favor të shitësit jashtë kësaj zyre [...].
50. Ndërsa me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme apartament nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.11.2002 të lidhur para noteres D. Z., shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e shitësit, i ka shitur z. H. K. (babait të subjektit të rivlerësimit) *pasurinë e paluajtshme të llojit apartament banimi, në pallatin {\*\*\*}, shkalla {\*\*\*}, ap. nr. {\*\*\*}, kati i {\*\*\*}, i përbërë nga 103 m<sup>2</sup> [...] përkundrejt shumës 41.360 dollarë amerikanë, pagesë kjo e kryer jashtë kësaj zyre.* Ky apartament i është shitur subjektit të rivlerësimit në vijim me anë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.10.2003, të lidhur para noteres I. L., kundrejt shumës 5.000.000 lekë për t’u paguar në momentin e lëvrimin të kredisë nga Banka e Kursimeve.
51. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, e pyetur në lidhje me pagesat e kryera për blerjen nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK të apartamentit të banimit nga subjekti i rivlerësimit, shoqëria ndërtuese ka përcjellë informacion se, lidhur me kontratën e shitjes së znj. Evjeni Sinojmeri, mbajtur më datë 07.01.2012, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., për pasurinë me nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, pagesat e kryera për këtë blerje të znj. Evjeni Sinojmeri, janë: *Paguar cash, datë 17.01.2000, shuma 10.000 (dhjetë mijë) dollarë. Paguar cash, datë 30.10.2000, shuma 10.000 (dhjetë mijë) dollarë. Paguar cash, shuma 6.855 (gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) dollarë [...].*
52. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se informacioni i përcjellë nga kjo shoqëri lidhur me pagesat e kryera për blerjen e apartamentit, nuk bie ndesh me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes në të cilën citohet se pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale përpara momentit të lidhjes së kontratës, pa specifikuar datën/datat e pagesave. Në këtë kuptim, këto të dhëna të administruara gjatë hetimit administrativ, me të drejtë, janë trajtuar nga Komisioni si gjetje për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e sa më sipër, barrë prove të cilën subjekti i rivlerësimit vlerësohet të mos e ketë përmbushur, për sa kohë nuk ka dorëzuar as në Komision, as bashkëlidhur ankimit, dokumentacion justifikues në mbështetje të pretendimit të saj se pagesa e blerjes së këtij apartamenti është kryer në vitin 2012 dhe jo si informuar nga shoqëria ndërtuese, lidhur me dy pagesa të kryera me *cash* në shumat nga 10.000 euro secila, respektivisht në datat 17.01.2000 dhe 30.10.2000. Pretendimet e subjektit të

rivlerësimin se pagesat e kryera nga bashkëshorti sipas dy mandatpagesave të lëshuara nga shoqëria ndërtuese në emër të z. E. S. janë kryer prej këtij të fundit për llogari të të atit të subjektit, z. H. K., për efekt të blerjes së apartamentit me sip. 103 m<sup>2</sup>, shitur në vijim subjektit të rivlerësimin, mbeten në nivel deklarativ, të paprovuara jo vetëm gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, por edhe gjatë gjyqimit të çështjes në Kolegj.

53. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin që pretendimet e subjektit lidhur me faturat e OSHEE-së, për apartamentin objekt kontrolli, të depozituara bashkëlidhur ankimit, të cilat deri në vitin 2011 kanë qenë në emër të shoqërisë ndërtuese, nuk mund të provojnë pretendimin e saj se pagesat për blerjen e apartamentit janë kryer në vitin 2012, pasi ndryshimi i emrit në kontratën e shërbimeve utilitare në asnjë rast nuk mund të bëhet përpara kalimit të pronësisë së apartamentit nga shoqëria te subjekti i rivlerësimin, fakt ky për të cilin nuk ka dyshime që ka ndodhur në janar të vitit 2012, por që gjithashtu nuk përjashton as mundësinë e kryerjeve të pagesave për blerjen e apartamentit përpara këtij momenti. Po ashtu, pa efekt në këtë analizë u vlerësuan faturat e energjisë elektrike edhe sa i takon faturimit të kryer për periudhat 18.10.2011 – 18.11.2011 dhe 18.11.2011– 15.12.2011, të cilat përcjellin të dhëna lidhur me mënyrën e përdorimit të apartamentit dhe jo të kohës së kryerjeve të pagesave për blerjen e tij.
54. Në kontekst të sa më sipër, në analizën e kryer për vlerësimin e pranueshmërisë si prova të reja në proces, të faturave të energjisë elektrike të dorëzuara bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues çmoi se edhe në eventualitetin që këto akte do të pranoheshin si akte të dorëzuara konform nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, të pamundura për t'u depozituar më parë në Komision në kuadër të pretendimit tashmë të njohur të subjektit, lidhur me pamundësinë e saj shëndetësore për t'u kthyer në Shqipëri, bazuar në analizën e mësipërme, u arrit në përfundimin se ato do të provonin një fakt i cili nuk ndikon në vendimmarrje, duke e bërë të panevojshëm administrimin e tyre referuar nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
55. Në përfundim të sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë se në këtë proces është përcaktuar në mënyrë të qartë detyrimi kushtetues i subjekteve të rivlerësimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tyre<sup>12</sup> dhe në kuadër të këtij procesi, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të rezultuara nga hetimi administrativ, është e subjektit të rivlerësimin, trupi gjykues gjen të bazuar në situatën faktike të konstatuar nga Komisioni, qëndrimin e këtij të fundit për të verifikuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesave për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2000 dhe jo në vitin 2012.
56. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimin lidhur me burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

**56.1.** *Lidhur me të ardhurat nga paga e bashkëshortit, z. E. S., për vitet 1985-1992, si mësuës në shkollën e mesme të përgjithshme “{\*\*\*}”, Gjirokastër, subjekti i rivlerësimin kundërshtoi si të padrejtë dhe të pabazuar mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se, për këtë periudhë, ka paraqitur edhe dokumentacionin justifikues për të vërtetuar faktin që ai ka punuar si mësuës, ndonëse nuk mund të provojë masën e tyre për shkak të mungesës*

---

<sup>12</sup> Shih nenin D të Aneksit ë Kushtetutës.

së dokumentacionit nga institucionet e shtetit. Subjekti pretendoi se, duke qenë se pagat për këtë sektor kanë qenë të unifikuara në nivel vendi, të ardhurat e deklaruara për këtë periudhë duhet të ishin marrë në konsideratë nga Komisioni. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur ankimit edhe dokumentin e titulluar “Akt verifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994”, lëshuar nga Arkiva Vendore e Gjirokastrës.

**56.2.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka llogaritur të ardhura nga paga për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar në rubrikën e të ardhurave për bashkëshortin e saj: *Të ardhura nga puna e bashkëshortit E. S. si mësues në shkollën e mesme të përgjithshme “{\*\*\*}”, Gjirokastrë, për periudhën 20.11.1982 - 31.08.1987, me përfaqësi në vlerën 41.000 lekë (mungojnë dokumentet). [...] Të ardhura nga puna e bashkëshortit E. S. si mësues në shkollën e mesme të përgjithshme “{\*\*\*}”, Gjirokastrë, për periudhën 01.09.1988 – 01.07.1992, 33 mijë lekë me përfaqësi (mungon dokumentacioni).* Këto deklarime, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit i ka shoqëruar me vërtetimin e institucionit arsimor, gjimnazi “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*} prot., datë 17.10.2016, sipas të cilit ky institucion nuk disponon të dhëna mbi pagat, si dhe vërtetimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastrë me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.10.2016, sipas të cilit në arkivin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastrë nuk ndodhen listëpagesa para datës 1.2.2007. Në kuadër të hetimit të kryer nga Komisioni, si dhe verifikimit të kryer nga ILDKPKI-ja, nuk rezulton të jenë administruar të dhëna të cilat konfirmojnë të ardhurat e deklaruara nga subjekti për bashkëshortin e saj nga punësimi pranë DAR Gjirokastrë për periudhat e sipërcituara. Në këto kushte, bazuar në dokumentacionin e fashikullit të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se Komisioni me të drejtë nuk ka përlllogaritur në zërin e të ardhurave, të ardhura nga pagat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën e punësimit të tij si mësues në Drejtorinë Arsimore Rajonale Gjirokastrë.

**56.3.** Megjithatë, në kuadër të një vendimmarrjeje sa më të drejtë dhe objektive, në konsideratë të faktit të një marrëdhënieje punësimi në sektorin shtetëror në periudhat e viteve 1982-1987 dhe 1988-1992, duke mos i atribuar subjektit të rivlerësimit pasojën e mungesës së ruajtjes nga institucionet shtetërore të listëpagesave për periudhat përkatëse, trupi gjykues vlerësoi ta pranojë si të drejtë këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit. Për arsye të sa më lart, duke qenë se subjekti i rivlerësimit i ka identifikuar vlerat e të ardhurave të përfituara në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues vendosi të verifikojë shumën e të ardhurave të deklaruara duke e vlerësuar atë në raport me vlerat referuese të pagave të kësaj periudhe<sup>13</sup>. Pas kontrollit të ushtruar nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues, pasi konstatoi se vlerat e deklaruara nuk tejkalonin masën e të ardhurave të realizuara sipas pagave referuese në shkallë vendi, vlerësoi ta njohë shumën totale të të ardhurave të deklaruara, prej 74.000 lekësh, nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si mësues në shkollën e mesme të përgjithshme “{\*\*\*}”, Gjirokastrë, si të ardhur të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe ta përfshijë këtë shumë në analizën financiare të Komisionit, në zërin e të ardhurave të bashkëshortit.

---

<sup>13</sup> Shih faqen zyrtare të ISSH-së: <http://www.issh.gov.al/>, si dhe tabelën me të dhëna për “Pagat referuese para datës 01.01.1994”: [http://www.issh.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Pagat\\_Referuese\\_para\\_1994.pdf](http://www.issh.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Pagat_Referuese_para_1994.pdf).

56.4. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në Gjermani, në periudhën korrik 1992 - mars 1993, subjekti pretendoi se të ardhurat e deklaruar nuk janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare të kryer lidhur me verifikimin e burimeve të pasurisë objekt kontrolli dhe se Komisioni nuk ka dhënë asnjë argument në vendim se përse nuk janë marrë në konsideratë këto të ardhura, për të cilat subjekti pretendoi të ketë dorëzuar në Komision 9 (nëntë) mandate bankare, ku vërtetohen tërheqjet e shumës prej 9.300 DM (markash gjermane).

56.5. Lidhur me shqyrtimin e këtij pretendimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhura nga emigracioni i bashkëshortit në Gjermani, në vlerën e 9324 markave, për periudhën 15.07.1992 – 01.05.1993, si i dërguar nga shteti shqiptar në shtetin gjerman, në kuadër të një marrëveshjeje punësimi me këtë të fundit, duke deklaruar se dokumentacioni për periudhën korrik – prill 1993 mungon. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues në gjuhën gjermane, siç shprehet dhe në ankim.

56.6. Trupi gjykues vëren se dokumentacioni justifikues në gjuhën gjermane nuk rezulton të jetë shoqëruar më një përkthim zyrtar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, konstatohet se nuk është dorëzuar as marrëveshja e punësimit sipas së cilës, referuar subjektit të rivlerësimit, bashkëshorti i saj është dërguar nga shteti shqiptar në Gjermani, nga ku mund të konstatoheshin elemente të nevojshme për vlerësimin e të ardhurave të deklaruar si të krijuara nga ky burim. Megjithatë, nga një përkthim jozyrtar i dokumentacionit të dorëzuar, trupi gjykues konstaton se në këto akte paraqitet emri i kompanisë MC Donalds Munih, Gjermani, me përshkrimin “Lista e pagave”, në emër të E. S., të hartuara për periudhën korrik 1992 - mars 1993. Në përmbajtje të çdo akti, paraqitet “shuma e pagesës” së përfituar çdo muaj nga bashkëshorti i subjektit, ku në total, për periudhën korrik 1992 - mars 1993, rezultojnë të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i subjektit në shumën 9.006,63 DM. Gjithashtu, vihet re edhe zëri me emërtimin “Zbritje tatimore”, ku për çdo muaj rezulton të jenë përlllogaritur shuma të ndryshme në bazë të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit.

56.7. Në shqyrtim të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se nga dokumentacioni i dorëzuar, arrihet të provohet pala punëdhënëse, pagesa e përfituar dhe fakti se lidhur me këto pagesa, janë mbajtur respektivisht edhe detyrimet tatimore për llogari të shtetit gjerman. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të drejtë dhe të bazuar në fakte pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në zërin e të ardhurave të bashkëshortit të ardhurat e realizuara nga punësimi i tij në Gjermani, në shumën e verifikuar prej 9.006,63 DM<sup>14</sup> gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj.

56.8. Lidhur me të ardhurat e deklaruar si të krijuara nga subjekti i rivlerësimit nga aktiviteti i saj si notere në periudhën shkurt 1996 – prill 2001, subjekti pretendoi se në mënyrë të padrejtë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën e Komisionit për vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli. Subjekti pretendoi se për të provuar këto të ardhura të realizuara nga puna si notere për periudhën shkurt 1996 - prill 2001, ka paraqitur së bashku me deklaratën *vetting*, vërtetimin e datës 23.01.2017, të lëshuar nga notere G. K. dhe bashkëlidhur ankimit ka depozituar një vërtetim të

---

<sup>14</sup> E konvertuar në shumën prej 513.970 lekësh, sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitet 1992 dhe 1993, 1 DM = 57,06 lekë.

dytë të datës 21.06.2021, të së njëjtës notere, në të cilin referohet shuma e të ardhurave të realizuara prej 3.683.982 lekësh.

**56.9.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*: *Të ardhura nga puna si notere pranë Dhomës së Noterisë Gjirokastër për periudhën 08.02.1996 – 31.12.2000. Mungojnë dokumentet (vërtetimet, datë 12.10.2016 dhe datë 20.10.2016, të DR Tatimeve). 6.000.000 lekë, këto me përfaqësi, për sa mbaj mend.* Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar: (i) kopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 13.02.1996, me anë të të cilit subjekti i rivlerësimit është njohur si person fizik për ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e noterisë, duke u bërë dhe regjistrimi përkatës pranë kësaj gjykate dhe kopje të lejes së ministrit të Drejtësisë nr. {\*\*\*}, datë 12.02.1996, për ushtrimin e profesionit të noterit, nga znj. Evjeni Sinojmeri; (ii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 23.01.2017, i noteres së Dhomës së Noterisë Gjirokastër, znj. G. K., me anë të të cilit kjo e fundit vërteton se pranë saj ndodhen të depozituar Regjistri i Përgjithshëm i Akteve dhe Veprimeve Noteriale nr. 1, Regjistri i Përgjithshëm i Akteve dhe Veprimeve Noteriale nr. 2 dhe Regjistri i Përgjithshëm i Testamenteve të ish-noteres Evjeni Sinojmeri; (iii) shkresë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2016, me anë të së cilës, në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, datë 11.10.2016<sup>15</sup>, për vënien në dispozicion të informacionit mbi të ardhurat neto të përfituara lidhur me ushtrimin e aktivitetit si person fizik në rrethin e Gjirokastrës për periudhën 08.02.1996-31.12.2000, informojnë se në bazë të verifikimeve të kryera prej tyre në sistemin e-c@ts, nuk disponohen të dhëna. Referuar akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se, në përgjigje të shkresës së këtij të fundit nr. {\*\*\*} prot., datë 24.02.2021, me anë të së cilës janë kërkuar të dhënat lidhur me subjektin tatimpagues Evjeni Sinojmeri, të regjistruar pranë kësaj drejtorie rajonale tatimore në periudhën 1996-2000, Drejtoria e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 9.3.2021, ka informuar se, pas verifikimeve të bëra në sistemin informatik tatimor C@ts, znj. Evjeni Sinojmeri nuk rezulton të ketë ose të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të saj. Sipas këtij institucioni, nuk ka deklarata të ngarkuara në sistem.

**56.10.** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht faktit që provohet ushtrimi i aktivitetit privat si notere në periudhën e viteve 1996-2001, shuma e të ardhurave të krijuara nga kjo veprimtari dhe pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore mbetën të paprovuara. Në këto kushte, çmohet se me të drejtë Komisioni nuk i ka përfshirë të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në zërin e të ardhurave në analizën financiare të kryer për efekt të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.

**56.11.** Sa i takon vërtetimit të datës 21.06.2021, të lëshuar nga notere G. K., të depozituar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, sipas të cilit të ardhurat e pasqyruara në regjistrat ku janë evidentuar aktet dhe veprimet noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, kapin vlerën e 3.683.982 lekëve, trupi gjykues konstatoi fillimisht se ky akt është përcjellë për herë të parë në Kolegj dhe nuk i është nënshtruar hetimit administrativ nga Komisioni, në funksion të të provuarit

<sup>15</sup> Shkresa mban vulën e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.10.2016.

të të ardhurave të ligjshme të deklaruara prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në analizë të pranueshmërisë së këtij akti të paraqitur si provë e re në proces, në kuadër të parashikimeve të neneve 47 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, ndonëse pretendon se për shkak të një pune voluminoze që kërkonte shumë kohë, mezi ka mundur ta marrë këtë vërtetim në datën 21.06.2021, rreth 2 muaj pasi është dhënë vendimi i Komisionit dhe 3 muaj pas marrjes së rezultateve të hetimit administrativ, nuk rezulton që në shpjegimet e saj ndaj rezultateve të hetimit administrativ, ku duket të ketë evidentuar kundërshtinë e saj me vlerësimin e Komisionit për mospërfshirjen në llogaritje të të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti i noterisë, nuk i ka kërkuar kohë shtesë Komisionit për të depozituar këtë akt, në kuadër të barrës së provës që i kishte kaluar dhe as ka bërë me dije Komisionin se, lidhur me këtë çështje, ishte në pritje të një akti me të cilin do të provonte masën e këtyre të ardhurave në kushtet e mungesës së të dhënave në organet tatimore. Përkundrazi, subjekti është shprehur se Komisioni duhet t'i kishte kërkuar Dhomës Kombëtare të Noterisë sa ka qenë mesatarja vjetore e të ardhurave të realizuara nga noterët për periudhën 1996-2001, pretendim ky i cili çmohet i pabazuar pasi Komisioni në këtë proces ka detyrë të verifikojë të ardhurat reale të krijuara nga subjektet e rivlerësimit dhe jo ato potencialisht të mundshme për t'u realizuar.

56.12. Gjithashtu, në vlerësim të përmbajtjes së këtij akti dhe vlerës së tij provuese, trupi gjykues fillimisht konstatoi se shumica e të ardhurave të deklaruara në këtë akt, nuk përputhet me shumën e të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për më tepër, vihet re se në këtë vërtetim, nuk specifikohet nëse të ardhurat e referuara janë paraqitur në vlerë bruto apo në vlerë neto, si dhe as tregohet mënyra se si janë përlllogaritur ato. Në këtë kuptim, trupi gjykues arriti në përfundimin se vërtetimi i datës 21.06.2021, i lëshuar nga notere G. K., jo vetëm nuk përmbush kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për t'u pranuar si provë e re në proces, por edhe nëse do të pranohej, marrja e tij duket se është e panevojshme pasi akti çmohet pa vlerë provuese në drejtim të përcaktimit të masës së të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i noterisë së ushtruar nga subjekti i rivlerësimit.

57. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, pasi kontrollloi analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 1985-2000, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, duke marrë në konsideratë edhe të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga paga si mësues, sipas vlerës së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në shumën 74.000 lekë, si dhe të ardhurat e përfituara nga emigrimi i tij në Gjermani, në shumën 9.006 DM, të konvertuara në shumën 543.782 lekë, si dhe duke përlllogaritur shpenzimet e jetesës sipas standardit të aplikuar nga Kolegji në masën e 30% të të ardhurave të realizuara për periudhën 18.08.1985 – 08.02.1996 dhe në masën 66% të të ardhurave për periudhën 08.02.1996 – 1999, në total në shumën prej 512.480 lekësh, shtuar këtu edhe shpenzimet e jetesës së bashkëshortit të subjektit gjatë qëndrimit të tij në Gjermani për 9 muaj, në shumën prej 438.682 lekësh, trupi gjykues konstatoi se lidhur me krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri dhe bashkëshorti i saj rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesave në vitin 2000, në shumën (-) 1.957.171 lekë.

58. Trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse do të merrej në konsideratë shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër nr. {\*\*\*} prot., datë 24.11.2022, në cilësinë e provës së re në proces, e dorëzuar së bashku me parashtrimet, e cila u vlerësua se nuk e kalon testin e pranueshmërisë, sipas

parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, duke përlllogaritur në këtë rast si fitim të realizuar nga subjekti i rivlerësimit nga aktiviteti i noterisë, shumën neto prej 1.272.520 lekësh, të përlllogaritur sipas një marzhi fitimi në masën 80% të qarkullimit vjetor të deklaruar sipas kësaj shkrese, pas zbritjes së tatimit të paguar për këtë periudhë 1997-1999, përsëri subjekti i rivlerësimit nuk do mund ta përmbyste rezultatin negativ të analizës së kryer për këtë pasuri, duke rezultuar edhe në këtë rast me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e (-) 595.123 lekëve<sup>16</sup>.

59. Në këto kushte, konkluzioni i Komisionit se *subjekti i rivlerësimit është në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme* për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, gjendet i bazuar në fakte e në ligj.
60. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sip. 103,4 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 2004, me vendndodhje në Rrugën {\*\*\*}, Tiranë, për të cilën subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.*
61. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” burimin e krijimit për pasurinë apartament, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Nga hetimi ka rezultuar se kredia bankare ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie.*
62. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të padrejtë konstatimin e Komisionit se për këtë apartament, nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie, ndërkohë që ka deklaruar blerjen e saj me kredi bankare dhe se vetë Komisioni në vendim ka bërë analizë lidhur me verifikimin që i është bërë këtij burimi të krijimit të pasurisë.
63. Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në parashikimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë, përveç kontrollit të pasurive në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të tyre dhe përmbushjes së detyrimeve përkatëse tatimore, objekt kontrolli nga institucionet e rivlerësimit është edhe vlerësimi i saktësisë dhe plotësisë së deklarimit të tyre. Në këtë kontekst, konstatimi i Komisionit gjendet i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në kushtet kur Komisioni, duke mbajtur në konsideratë faktin që burimi i përdorur për krijimin e kësaj pasurie, i verifikuar gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar pa problematika, me të drejtë nuk i ka atribuuar subjektit të rivlerësimit pasojën juridike të deklarimit të pamjaftueshëm. Në këtë kontekst, shkak i ankimit të subjektit të

---

<sup>16</sup>Përfshirë këtu edhe efektin në të ardhurat e krijuara nga emigracioni i bashkëshortit në Gjermani, sipas aktit të “Agjencisë Shtetërore të Sigurimeve të Bavarisë së Epërme, Munih”, të datës 13.01.1998, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj së bashku me parashtrimet, sipas të cilit rezultoi se bashkëshortit të saj E. S. i është rimbursuar nga sigurimet shoqërore në Gjermani, shuma prej 1.568,85 DM, e konvertuar në shumën 89.527 lekë, që përfaqëson pjesën e mbajtur nga paga për efekt të pensionit që mund të merrte në Gjermani, nëse do të jetonte aty. Ndonëse ky akt u vlerësua se nuk e kalonte testin e pranueshmërisë së tij si provë e re në proces, sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në kuadër të paraqitjes së variantit më garantist për subjektin e rivlerësimit, u përlllogarit edhe efekti i tij si më sipër.

rivlerësimin, në vlerësim të trupit gjykues, nuk paraqet ndonjë relevancë në drejtim të vlerësimin të kësaj pasurie.

64. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sip. 66,2 m<sup>2</sup>, objekt i kontratës së sipërmarrjes të lidhur në vitin 2004, me vlerë 28.000 euro, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, dhe me pasurinë e paluajtshme të llojit “garazh”, me sip. 19,1 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, të blerë në vitin 2004, për të cilat subjekti i rivlerësimin kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit, trupi gjykues vëren se:
65. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimin lidhur me verifikimin e kryer mbi ligjshmërinë e krijimit të këtyre dy pasurive të paluajtshme, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimin ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjet e tyre në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se subjekti i rivlerësimin as gjatë hetimit, por dhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
66. Subjekti i rivlerësimin kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare për krijimin e këtyre pasurive në vitin 2004 dhe pretendoi se ky konkluzion është rrjedhojë e analizës së gabuar financiare të bërë nga Komisioni që në fillim, për vitet 1985-2000, dhe daljes me bilanc negativ për këto vite në shuma të konsiderueshme, gjë që ka sjellë që, vit pas viti, bilanci negativ pas çdo blerjeje të shtohet.
67. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 66,2 m<sup>2</sup>, subjekti kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me momentin e blerjes së kësaj pasurie. Subjekti pretendoi se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për ta blerë këtë pasuri nga vëllai i saj në vitin 2009 dhe jo në vitin 2004. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimin pretendoi se pagesa e kryer në vitin 2004 nga bashkëshorti i saj për këtë apartament, është bërë për llogari të vëllait të saj, z. A. K., i cili ndodhej në Greqi. Sa më sipër, sipas subjektit, provohet nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 01.10.2004. Në kuadër të sqarimit të rrethanave të kësaj blerjeje, subjekti i rivlerësimin pretendon se në vitin 2009, vëllai i saj ndryshoi mendim në lidhje me apartamentin dhe, për rrjedhojë, ajo së bashku me bashkëshortin e saj vendosën që t’i kthenin z. A. K. vlerën e investuar dhe të mbanin për vete apartamentin e porositur në emër të vëllait. Subjekti argumentoi se edhe nëse do të ishte blerje e saj, duke qenë se bëhej fjalë për një kontratë sipërmarrje, ajo nuk do të ishte deklaruar prej saj dhe, rrjedhimisht, duke mos deklaruar kontratën e sipërmarrjes, nuk kishte si të deklaronte deklaratën noteriale. Sipas subjektit, nëse këtë apartament do ta kishte blerë për vete në vitin 2004, do ta kishte më të lehtë të deklaronte marrjen borxh të shumës prej 28.000 eurosh nga i vëllai dhe më pas kthimin e saj. Subjekti kundërshtoi gjithashtu edhe konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të vëllait për të krijuar të ardhurat e pretenduara si të investuara në blerjen e apartamentit në vitin 2004, me pretendimin se vëllai ka qenë emigrant që në vitin 1991 në Greqi, i cili ka punuar në këtë shtet në profesionin e muzikantit, por se ky aktivitet ka qenë informal për shkak të situatës lidhur me emigrantët ekonomikë në vitet 1991-2003. Sipas subjektit të rivlerësimin, deklarata noteriale e vitit 2004 është një dokument i besueshëm, i përpiluar nga një person që ushtronte funksion publik dhe, për këtë arsye, përbën provë të plotë për deklarimet që janë bërë në të.

68. Ndërsa, lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “garazh” me sip. 19,1 m<sup>2</sup>, subjekti pretendoi se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, mundësitë financiare për ta blerë këtë pasuri kanë qenë të mjaftueshme, pa prekur shumën fillestare të parave që kanë qenë gjendje në fillim të vitit 2004, në shumën prej 30.000 USD. Sipas subjektit të rivlerësimit, për blerjen e garazhit kanë shërbyer të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2004, nga të cilat, përveç shpenzimeve për jetesën e përditshme, janë kursyer në formë likuiditeti *cash* në fund të këtij viti edhe shuma prej 500.000 lekësh. Në kuadër të pretendimit për konkluzion të gabuar të analizës financiare të këtij viti, subjekti pretendoi gjithashtu se vlera e shpenzimeve të udhëtimit të përlogaritura nga Komisioni për këtë vit, në shumën 514.564 lekë, është e gabuar, pasi udhëtimet e kryera nga subjekti kanë qenë për shkak të detyrës së saj.
69. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerësoi fillimisht të marrë në analizë momentin e krijimit të pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me sip. 66,2 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, për të cilën ka pretendime për të mos e përfshirë në analizën financiare të vitit 2004, sikundër ka bërë Komisioni. Lidhur me sa më sipër, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
- 69.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe 66,2 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 7,95 m<sup>2</sup>, të blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 18.12.2015, kundrejt shumës prej 28.000 eurosh. Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit teksa ka deklaruar blerjen e një apartamenti në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në shumën e 28.000 eurove, me kontratë sipërmarrjeje (të titulluar *Shitblerje me kusht*), me burim pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitet paraardhëse, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: *Apartamenti që deklarova në fq. 3, nuk është deklaruar më parë pasi është blerë për vëllain tim A. K.. Me deklaratën noteriale të datës 1 tetor 2004, ai i ka dhënë bashkëshortit tim E. një sasi prej 28.000 eurosh, me qëllim porositjen e këtij apartamenti dhe ka autorizuar njëkohësisht që kontratën e sipërmarrjes ta lidhte bashkëshorti im në emër të vet, ndërsa kur të përfundonte ndërtimi, kontratën e shitjes do ta nënshkruante vetë A.. Në vitin 2009, A., për arsytet e veta, rimori shumën e dhënë nga E. dhe apartamenti do të mbetet në pronësinë tonë. Kontrata përfundimtare ende nuk është lidhur pasi tani ka përfunduar ndërtimi dhe nuk është bërë ende regjistrimi i pronës në ZRPP.*
- 69.2. Sipas “Kontratës së shitblerjes me kusht pasurie të patundshme (apartament banimi)” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.11.2004, të lidhur para noterës Q. Sh., mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e shitësit dhe z. E. S., në cilësinë e blerësit, në ndërtesën 7-, 8- e 9-katëshe të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, shitësi i shet blerësit një apartament banimi me sipërfaqe 73,5 m<sup>2</sup>. Referuar përmbajtjes së kontratës, shitësi deklaroi se *ia shet blerësit, z. E. S., këtë apartament përkundrejt çmimit prej 28.000 eurosh, shumë të cilën blerësi, z. E. S., ua ka likuiduar shitësve tërësisht në dorë jashtë kësaj zyre noteriale.*
- 69.3. Me “Kontratën e shitblerjes (pasuri e paluajtshme, apartament banimi)” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.12.2015, të lidhur para noterit N. I. V., mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e shitësit dhe z. E. S., në cilësinë e blerësit, pasuria që shitet është një apartament banimi, i regjistruar me [...], në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me sip. 66,2 m<sup>2</sup>. Referuar parashikimit në këtë kontratë, çmimi i shitjes përcaktohet në shumën e 28.000 eurove dhe deklarohet nga shitësi si i

marrë në vlerë totale para redaktimit të kësaj kontrate në bazë të “Kontratës së shitblerjes me kusht, pasurie e paluajtshme (apartament banimi)” me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.11.2004.

69.4. Trupi gjykues vëren gjithashtu se në fashikullin e ILDKPKI-së, së bashku me “Kontratën e shitblerjes me kusht, pasurie të patundshme (apartament banimi)” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.11.2004, ndodhet edhe një akt shkresor i titulluar “Deklaratë noteriale”, datë 01.10.2004, e dhënë nga shtetasit A. K. dhe E. S. përpara noteres A. P., anëtare e Dhomës së Noterisë Gjirokastrë. Në drejtim të elementeve formale të kësaj deklarate noteriale, bie në sy fakti që ky akt nuk përmban asnjë kredencial që t’i referohet regjistrimit të tij në regjistrin e akteve dhe veprimeve noteriale, detyrim ligjor ky i përcaktuar në nenin 70 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar deri në kohën e përpilimit të aktit. Në drejtim të përmbajtjes së tij, konstatohet se z. A. K. (vëllai i subjektit të rivlerësimit) ka deklaruar: *Unë, A., kam në pronësinë time një sasi prej 28.000 (njëzet e tetë mijë) eurosh, të cilat kam vendosur t’i investoj për blerjen e një apartamenti banimi në qytetin e Tiranës. Duke qenë se vetë jam prej vitesh me banim në shtetin grek dhe nuk kam mundësi për t’u interesuar, kam rënë dakord me kunatin tim/deklaruesin E., i cili banon në Tiranë, që të kontaktojë me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}”, e cila po ndërton një pallat në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Unë, E., i kam dhënë gjithë sasinë prej 28.000 eurosh, me të cilën ai do të porosinë një apartament rreth 70 m<sup>2</sup> ose dhe me sipërfaqe më të madhe nëse do të mjaftojë kjo sasi paraje. Kontratën e sipërmarrjes kemi rënë dakord që ta lidhë në emër të tij, por, kur apartamenti të përfundojë dhe të lidhet dhe kontrata e shitjes, unë do të paraqitem vetë për të nënshkruar ose, në varësi të rrethanave, mund ta pajis me prokurë për të më përfaqësuar mua si blerës.*

70. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se Komisioni me të drejtë ka konkluduar se pagesat e bëra për efekt të kontratës së sipërmarrjes nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2004, duhen përfshirë në analizën financiare të kryer për efekt të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, për sa kohë pretendimet se pagesat për blerjen e apartamentit në vitin 2004, janë kryer nga bashkëshorti i subjektit për llogari të vëllait të saj, mbeten të paprovuara. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pasi vlerësoi se deklarata noteriale si më sipër cituar, nuk mund të provojë faktin se kontrata e lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK në vitin 2004, nga z. E. S., është bërë në emër të tij dhe për llogari të z. A. K., për sa kohë ky fakt nuk është deklaruar në kontratën e sipërmarrjes dhe as rezulton që kjo kontratë të shprehë në çfarëdo lloj mënyre këtë vullnet të palëve, për të përfaqësuar z. K. nga z. S. në marrëdhënien juridiko-civile të krijuar me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për blerjen e një apartamenti banimi me sip. 66,2 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”. Fakti që gjatë hetimit të zhvilluar në Komision, nuk rezultoi asnjë e dhënë tjetër në mbështetje të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, krijoi bindjen e trupit gjykues se qëndrimi i Komisionit për vlerësimin se pagesa për blerjen e apartamentit objekt kontrolli nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të është kryer në vitin 2004 dhe jo në vitin 2009, është i bazuar në fakte.

71. Provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj më datë 24.10.2024, së bashku me parashtrimet me shkrim, përveçse u vlerësuan nga trupi gjykues se nuk përmbushin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 për t’u pranuar si prova të reja në proces, sa kohë nuk u konstatua asnjë fakt i cili të dëshmonte se këto akte kanë qenë të pamundura për t’u siguruar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ose më së paku në momentin e dorëzimit të ankimit, u çmuan

gjithashtu pa relevancë në vendimmarrjen e trupit gjykues lidhur me shqyrtimin e këtij shkaku ankimi. Sa më sipër, duke qenë se akti “Vërtetim i vjetërsisë në punë”, datë 05.10.2022, i {\*\*\*} Janinë” (i përkthyer dhe noterizuar), edhe nëse do të provonte të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A. K., përsëri nuk do të provonte faktin se vlera monetare objekt kontrolli i është dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga vëllai i saj. Po ashtu, pa vlerë provuese në drejtim të faktit të sipërcituar, u vlerësua edhe akti “Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 13.02.2023, e lëshuar nga A. K.”, e cila ka të njëjtën përmbajtje me një deklaratë ekzistuese në fashikull, të marrë në analizë më sipër.

72. Sa i takon kontrollit të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2004, në drejtim të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të për krijimin e dy pasurive të paluajtshme objekt kontrolli sipas këtij shkaku ankimi, mbi bazën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

*72.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të gabuar të shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2004, në vlerën e 514.564 lekëve, trupi gjykues, pasi kontrolloi zërin e shpenzimeve të udhëtimit dhe përlllogaritjen e tij në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Kolegji në vendimin e tij orientues për këtë çështje<sup>17</sup>, konstatoi se përlllogaritjet e kryera nga Komisioni ishin të bazuara në fakte, duke qenë se subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, nuk kishte paraqitur në Komision akte justifikuese për të provuar pretendimin e saj se udhëtimet e kryera kanë qenë udhëtime pune dhe shpenzimet lidhur me to nuk janë mbuluar prej saj.*

73. Për rrjedhojë të sa më sipër, në konsideratë edhe të konkluzionit të arritur nga trupi gjykues lidhur me kryerjen e pagesës në shumën e 28.000 eurove në vitin 2004, për pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 13.02.2004 - 01.10.2004, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të gjendeshin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “garazh” dhe “apartament banimi” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me të njëjtin rezultat financiar si Komisioni prej – 4.259.543 lekësh.
74. Trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse do të merreshin në konsideratë, në përlllogaritjet e shpenzimeve të udhëtimit, aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provave të reja së bashku me parashtrimet, të cilat u vlerësuan se nuk kalojnë testin e pranueshmërisë sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit sërish do të ndodhej në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në shumën e (-) 4.099.597 lekëve.
75. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, së bashku me personin e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme lidhur me krijimin e këtyre dy pasurive të paluajtshme objekt kontrolli, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>17</sup> Sipas vendimit të Kolegjit nr. (JR) 11, datë 22.05.2019.

76. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sip. 128 m<sup>2</sup>, objekt i kontratës së sipërmarrjes të lidhur në vitin 2004, me vendndodhje në lagjen “{\*\*\*}”, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare për pagesën e këstit të parë dhe kohës se kur janë paguar këstet e tjera, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
77. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaratimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se subjekti i rivlerësimit as gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.
78. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit në drejtim të mungesës së burimeve financiare për pagesën e këstit të parë sipas kontratës së sipërmarrjes dhe kohës se kur janë paguar këstet e tjera. Në kuadër të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur ankimit edhe 3 mandatarkëtime, respektivisht: (i) me nr. {\*\*\*}, në shumën 20.000 euro, pa datë, po sipas subjektit i takon këstit të parë të paguar në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, 12.02.2004; (ii) me nr. {\*\*\*}, datë 27.01.2005, në shumën 15.000 euro; dhe (iii) nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2006, në shumën 5000 euro. Subjekti sqaroi se nuk ka mundur të gjejë mandatarkëtimin për shumën 17.600 euro që, sipas saj, duhet të jetë paguar në muajin dhjetor 2006. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë prej 20.160 eurosh, është i gabuar, pasi ajo ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit 2003 në shumën prej 30.000 USD.
79. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se mosdeklarimi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, vjen si pasojë e faktit se objekt deklarimi kanë qenë sendet mbi të cilat ishte fituar pronësia apo ushtrohej një e drejtë reale, ndërkohë që sipërmarrja nuk përfshihet në të drejtat reale, por në të drejtat e detyrimit. Sipas subjektit, në momentin kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, objekti ka qenë në ndërtim dhe mbi të nuk ushtrohej asnjë e drejtë reale. Për këtë qëllim, deklarimi është kryer në deklaratën periodike të vitit 2006 kur edhe formulimi në DIPPV-në e këtij viti i referohej çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.
80. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren fillimisht se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi konstatimet e Komisionit për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e interesave private të vitit 2004 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, por deklarimin e saj në deklaratën periodike të vitit 2006, si dhe shpjegimet e dhëna lidhur me arsyet e këtij mosdeklarimi çmohen pa relevancë në shqyrtimin e këtij shkakut ankimi, sa kohë rezultoi që konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri lidhet vetëm me mungesën e burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së saj, sipas vlerës së dakordësuar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2004.
81. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit të saj 3 mandate pagesash, të cilat paraqiten për herë të parë në Kolegj. Nga shqyrtimi i këtyre akteve në kuadër të parashikimeve të neneve 47 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit

nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se edhe nëse këto akte do të pranoheshin në cilësinë e provës së re në këtë proces, ato nuk do kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, për sa kohë konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për pagesat e kryera lidhur me blerjen e kësaj pasurie, lidhet vetëm me këstin e parë të apartamentit, në shumën prej 20.160 eurosh, të cilin Komisioni e ka përlllogaritur si të paguar në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, 12.02.2004, që përkon me pretendimin e vetë subjektit të rivlerësimit, ndonëse mandatar-këtimi i depozituar prej saj bashkëlidhur ankimit nuk ka datë.

82. Në këto kushte, në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar në vlerësimin e burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë, bazuar në një analizë të ardhurash dhe shpenzimesh për periudhën 01.01.2004 - 12.02.2004, pasi ajo ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit 2003, në shumën prej 30.000 USD, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit bie ndesh me vetë deklaratimet e saj para ILDKPKI-së lidhur me likuiditetin gjendje *cash* në vitin 2004, i cili, referuar deklaratës periodike të këtij viti, nuk rezulton të jetë pakësuar, por përkundrazi të jetë shtuar edhe me 500.000 lekë, pavarësisht investimeve në blerje të dy pasurive të paluajtshme të tjera si më sipër analizuar.
83. Në përfundim, nga kontrolli i ushtruar nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizës financiare të Komisionit lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e këstit të parë të apartamentit, në shumën prej 20.160 eurosh, për periudhën 01.01.2004 - 12.02.2004, trupi gjykues konstatoi se analiza financiare paraqitet me të njëjtin rezultat negativ si Komisioni, me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 2.288.426 lekësh.
84. Në këto kushte, konkluzioni i arritur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, gjendet i bazuar në fakte dhe në ligj.
85. *Lidhur me shumën prej 3.900.000 lekësh që vjen nga shitja e pasurisë “truall + ndërtim” në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër*, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit se jo e gjithë vlera i takon subjektit të rivlerësimit, duke i zbritur kësaj kundërvlerën e një sipërfaqeje prej 34 m<sup>2</sup> të truallit që ka pasur në pronësi babai i subjektit të rivlerësimit, si dhe ndërtimit të kryer mbi të, me pretendimin se ndërtimi i kryer mbi truallin në pronësi të saj dhe bashkëshortit të saj me sip. 165 m<sup>2</sup> dhe truallit me sip. 34 m<sup>2</sup>, në pronësi të prindërve të saj, është kryer me investimin e subjektit dhe bashkëshortit të saj, dhe se pronësia mbi këtë bodrum të ndërtuar në vitin 1998, provohet edhe nga dokumentacioni ligjor përkatës (leja e ndërtimit, datë 11.03.1998). Subjekti pretendoi se prindërit e saj kanë hequr dorë nga kundërvlefata e truallit për sa kohë që trualli dhe objekti i ndërtuar mbi të iu shitën me çmim preferencial djalit të motrës së mamasë së subjektit. Edhe nëse do të zbritej kundërvlefata e pjesës takuese të truallit, kjo vlerë, sipas subjektit të rivlerësimit, do të ishte e papërfillshme.
86. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, i cili ka të bëjë me vlerësimin e masës së të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë “truall + ndërtim”, në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, të ardhura këto të marra në shqyrtim dhe të trajtuara në kuadër të analizës financiare mbi verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me sip. 92 m<sup>2</sup>, në lagjen nr. {\*\*\*}, Durrës, në vitin 2005, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë

**86.1.** Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga shitja e një trualli me sipërfaqe 165 m<sup>2</sup> dhe e një ndërtimi me sipërfaqe 199 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, të qytetit Gjirokastër, pasuritë nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} në ZK {\*\*\*}. Shitur me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., dhe {\*\*\*} kol., datë 26.01.2005. Shuma e të ardhurave neto nga ky transaksion është deklaruar nga subjekti në vlerën 3.900.000 lekë.*

**86.2.** Rezultoi se mbi bazën e kërkesës së datës 23.09.1996, të z. E. S., këtij të fundit i është dhënë sheshi i ndërtimit me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> me anë të “Vendimit për dhënie shesh ndërtimi”, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.08.1998, bazuar në vendimin e KRT të Rrethit Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 08.04.1998, dhe në vendimin e Këshillit të Qarkut Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 03.06.1998.

**86.3.** Në vijim të vendimit Këshillit të Qarkut Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 03.06.1998, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me vendimin e KRT-së së Rrethit Gjirokastër nr. {\*\*\*}, datë 21.07.1998, i është dhënë “Leja e ndërtimit” nr. {\*\*\*} prot., datë 11.08.1998, për objektin “Lokal e banesë “{\*\*\*}””. Objekti, sipas këtij akti, do të financohet nga E. S..

**86.4.** Me anë të akt marrëveshjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.06.2000, para noteres G. K., z. E. S. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) dhe z. H. K. (babai i subjektit të rivlerësimit) kanë rënë dakord si vijon: *Unë, H. K., kam të regjistruar në regjistrin e transkriptimit një sipërfaqe truall prej 34 m<sup>2</sup> ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër [...] . Unë, E. S., kam të regjistruar në regjistrin e transkriptimeve [...] një sipërfaqe truall prej 165 m<sup>2</sup>, që ndodhet në lagjen “{\*\*\*}”, në Gjirokastër [...]. Të dy palët në marrëveshje deklarojnë që me qëllim që të ndërtojnë një objekt sa më të plotë dhe funksional, gjë që nuk mund të realizohet me sipërfaqet e veçanta, ne biem dakord që ti bashkojmë këto troje dhe më mbrapa sipas një marrëveshjeje do të ndajmë pjesët në objektin që do të ndërtohet.*

**86.5.** Me anë të kontratës së shitjes pasuri e paluajtshme “truall + njësi”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.01.2005, të lidhur para noteres A. I. P., z. E. dhe E. S., si pronarë të pasurisë “tokë truall” me sip. 165 m<sup>2</sup> [...] dhe të pasurisë “bodrum” nëntokë, në kuotën -2,80 metra me sipërfaqe 199 m<sup>2</sup> [...], dhe z. H. dhe znj. A. K., si pronarë të pasurisë së paluajtshme “truall” me sip. 34 m<sup>2</sup> [...], me vendndodhje në lagjen “{\*\*\*}”, në Gjirokastër, në cilësinë e palës shitëse, kanë rënë dakord me z. Sh. G., në cilësinë e palës blerëse, për shitblerjen e këtyre pasurive të paluajtshme. Referuar kontratës së sipërcituar, këto pasuri, pala shitëse deklaroi se ka rënë dakord t’ia shesë palës blerëse kundrejt shumës 3.900.000 lekë, pagesë kjo e likuiduar.

**87.** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit për mosvlerësimin e gjithë vlerës së përfituar nga shitja e pasurive të paluajtshme vetëm nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, në cilësinë e njërit prej shitësve. Për sa kohë që çmimi i shitjes është përcaktuar në total për të gjitha pasuritë, objekt i kësaj kontrate tjetërsimi, rrjedhimisht të ardhurat e krijuara janë objekt i ndarjes në proporcion me pjesët takuese. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi investimin në ndërtimin e objektit vetëm nga bashkëshorti i saj, referuar lejes së ndërtimit të vitit 1998, paraqiten irrelevante, për sa kohë edhe pse kuptohet që palët në marrëveshje mes tyre, të drejtat mbi ndërtimin e kryer, ia kanë kaluar bashkëshortëve Sinojmeri, sa kohë që objekt i kontratës së shitblerjes është edhe truall mbi të cilin është ngritur ndërtimi, çmimi i shitjes u takon proporcionalisht të gjithë shitësve. I paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor mbeti gjithashtu edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se prindërit e saj

kishin hequr dorë nga kundërvlehtë e truallit si pasojë e shitjes së këtij trualli dhe objektit të ndërtuar mbi të, të afërmit të nënës së subjektit. Në këto kushte, çmohet i drejtë konkluzioni i Komisionit për përlogaritje në mënyrë përpjesëtimore të të ardhurave nga shitja e truallit dhe ndërtesës, në raport me pjesët takuese të pasurive të shitura, ndonëse konstatohet se përlogaritja proporcionale e kryer nga Komisioni, bazuar vetëm në raportet e pronësisë mbi truallin, nuk është e saktë, për sa kohë rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë në pronësi edhe bodrumin, përveç sipërfaqes së truallit prej 165 m<sup>2</sup>, krahasuar me të atin e subjektit, i cili ka kontribuar në shitblerjen, objekt kontrolli, vetëm me truallin me sipërfaqe prej 34 m<sup>2</sup>.

88. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, pasi konstatoi se këto të ardhura nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sip. 92 m<sup>2</sup>, në lagjen nr. {\*\*\*}, Durrës, as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit 2005, në konsideratë edhe të faktit që referuar deklaratës periodike të vitit 2006, vetë subjekti ka deklaruar pakësimin e të gjithë shumës së likuiditetit *cash*, të akumuluar ndër vite, përfshirë këtu dhe vlerën e të ardhurave prej 3.900.000 lekësh, të realizuara nga shitja e pasurive të sipërcituara vetëm në vitin 2006, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit në vendim për mos përlogaritjen e këtyre të ardhurave si burim për kryerjen e pagesës prej 30.000 eurosh, për efekt të blerjes së apartamentit të banimit në lagjen nr. {\*\*\*}, Durrës. Në këtë kuptim, pretendimet në lidhje me vlerën e të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë “truall dhe ndërtim”, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit, kësaj të fundit dhe prindërve të saj, nuk duket të ndikojë në konkluzionin e arritur nga Komisioni për mungesë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për krijimin e pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” në Durrës, konkluzion të cilin trupi gjykues, edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, e gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj.
89. *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet”, të tipit “Ford Focus”, e deklaruar në DIPPV-në e vitit 2011, si e blerë në 2010*
90. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramentit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, pasi ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion mbi të ardhurat e përfituara nga puna sezonale e djemve të saj, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezultojnë të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.
91. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, e ka kundërshtuar arsyetimin e Komisionit se për këtë pasuri nuk është provuar burimi i krijimit, si pasojë e mosparaqitjes së dokumenteve që të provojnë punësimin me kohë të pjesshme të djemve të saj, me pretendimin se paraqitja e dokumentacionit ka qenë e pamundur për shkak se subjekti ndodhej në SHBA, shtuar dhe faktin që punësimi i tyre ka qenë në periudhën e shkollës së mesme dhe universitetit dhe se ata janë paguar me lekë në dorë dhe jo nëpërmjet bankës, duke vështirësuar edhe procesin e marrjes së dokumenteve justifikuese. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se pjesa më e konsiderueshme e pagesës së çmimit të automjetit është kryer me dhuratat që kanë marrë fëmijët që prej lindjes së tyre. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto burime nuk do të ishin deklaruar nëse

nuk do të ishin të vërteta, pasi ajo dhe bashkëshorti i saj i kishin të gjitha mundësitë të justifikonin blerjen e automjetit me paratë që kishin.

92. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, pas verifikimit të akteve të fashikullit, duke marrë në konsideratë që subjekti i rivlerësimit: (i) në kuptim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, dokumentacion justifikues në mbështetje të deklarimeve të kryera, nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues lidhur me të ardhurat e deklaruara si burim për blerjen e automjetit “Ford Focus” në vitin 2010; si dhe (ii) në konsideratë të faktit që subjekti nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave, as pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, as në Kolegj, së bashku me ankimin në mbështetje të pretendimeve të ngritura në kundërshtim të vendimit të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, të ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e saj çmohen se nuk përmbushin standardin e të ardhurës së ligjshme, në kuptim të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi pamundësinë për të dokumentuar të ardhurat nga punësimi sezonal i djemve, duke qenë se ato nuk janë paguar nëpërmjet sistemit bankar, si dhe pretendimet se shuma më e konsiderueshme e pagesës së çmimit të automjetit, si pjesë e kursimeve familjare, u referohet dhuratave të marra prej fëmijëve që prej lindjes së tyre, vlerësohen të pabazuara. Të dy këto burime të ardhurash, qoftë nga puna e fëmijëve qoftë nga dhurimet e palëve të treta, referuar legjislacionit në fuqi, për deklarimin periodik të interesave privatë të subjekteve deklarues pranë ILDKPKI-së, kanë përbërë detyrim ligjor për deklarim referuar nenit 4, shkronja “e”, në kombinim me nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe neneve 5, pika 1, shkronja “c” dhe 15, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar<sup>18</sup>, fakt ky që nuk provohet të ketë ndodhur.
93. Trupi gjykues konstatoi se, në asnjë prej deklaratave periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar dhurime të tilla apo të ardhura nga punësimi sezonal i djemve të saj, duke arritur në konkluzionin që ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbeti i paprovuar. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e Komisionit se, për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit është ndodhur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas të njëjtit rezultat të rezultuar nga analiza financiare e kryer për këtë qëllim nga Komisioni.
94. *Lidhur me shumën prej 40.000 USD, të dërguar djalit të subjektit të rivlerësimit S. S. në SHBA*, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme, për krijimin e kursimeve në këtë vlerë, me pretendimin se gjatë vitit 2016 të ardhurat vjetore të familjes kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar këtë vlerë. Subjekti sqaroi se dërgesa e parave është kryer në dhjetëditëshin e parë të muajit maj dhe se, në atë moment, nuk disponohej e gjithë shuma, e cila sipas saj është plotësuar me vlerën prej 1.500.000 lekëve, të siguruar nga miqtë e subjektit dhe bashkëshortit të saj, shumë e cila, sipas subjektit të rivlerësimit, u është kthyer brenda vitit dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar në DIPPV-në e vitit 2016 dhe,

<sup>18</sup> Deri në vitin 2012, ku me ndryshimet që pësoi ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 me ligjin nr. 85, datë 18.09.2012, këto detyrime u integruan, duke u përcaktuar në nenin 4, shkronja “f” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

për rrjedhojë, sipas saj, nuk ka qenë e nevojshme përpilimi i dokumenteve të vërtetimit të faktit të mësipërm.

95. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, në vitin 2016, për efekt të kryerjes së kësaj pagese në favor të djalit të saj, i cili ndodhej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, subjekti i rivlerësimit kishte siguruar vlerën prej 1.500.000 lekëve nga miqtë e saj dhe të bashkëshortit të saj, por që, për shkak të kthimit brenda vitit, nuk e kishte deklaruar këtë hua në ILDKPKI, në deklaratën periodike të vitit 2016, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është i bazuar. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë jo vetëm faktin që, lidhur me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion që të provonte huamarrjen në këtë shumë, në vitin 2016, dhe kthimin e saj brenda të njëjtit vit deklarimi (vetë subjekti e pranon mosdokumentimin e këtij fakti) por, për më tepër, ky pretendim konstatohet se bie ndesh me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ. Më konkretisht, trupi gjykues konstatoi se, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga vetë subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, konkretisht formularit “Kërkesë për transfertë fondesh”, në rubrikën “Burimi i fondeve”, bashkëshorti i subjektit, si personi që ka urdhëruar transfertën bankare në favor të djalit të tij, ka deklaruar “kursime familjare”. Ky deklarim është në linjë me deklarin e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* në rubrikën të dhëna konfidenciale ku është shënuar *40.000 dollarë nga kursimet e mia familjare, dërguar djalit tim S. S., që jeton në Boston për nevojat e tij familjare*, si dhe në deklarin e saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ku ka shënuar: *Pakësuar pasuria me vlerën në USD, të cilat i janë dërguar nëpërmjet bankës djalit tim S. S. që jeton në Boston për t'i përdorur për nevojat familjare*.
96. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, ndonëse në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që ta deklaronte huanë e pretenduar në vlerën e 1.500.000 lekëve, të marrë nga miqtë e familjes, në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dorëzuar në datën 25.01.2017, duke ia nënshtruar atë hetimit lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të huadhënies, rezultoi të mos kishte deklaruar ndonjë fakt të tillë. Pretendimi i subjektit se ajo nuk kishte detyrim për ta deklaruar këtë hua të kthyer brenda vitit, u vlerësua i pabazuar, për sa kohë dispozitat e ligjit nr. 84/2016 që vendosnin këtë detyrim, në kuadër tashmë të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ishin miratuar që në gusht të vitit 2016 dhe subjekti i rivlerësimit prezumohet të ketë qenë në dijeni të parashikimit përkatës ligjor dhe në kohë, për të mundësuar dokumentimin e këtij fakti të pretenduar si të ndodhur gjatë vitit 2016.
97. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi kontrollloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me vlerësimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të justifikuar me burime të ligjshme këtë transfertë vlerash monetare në SHBA, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e këtyre kursimeve, në shumën (-) 2.032.364

lekë, ku ndryshe nga Komisioni<sup>19</sup>, në këtë analizë, u përllorarit konvertimi i transfertës në shumën prej 40.000 USD, me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 06.05.2016.

98. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin nga subjekti i rivlerësimit të konkluzionit të Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar investimin e kryer nga djali i saj në obligacionet e thesarit, në vlerën totale prej 9.600.000 lekësh, në vitet 2011, 2014 dhe 2015, me pretendimin se vlera e këtij investimi është plotësisht e justifikuar nga gjendja e likuiditeteve cash në momentin e blerjes së tyre, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi si vijon.*
99. Referuar informacionit të dhënë nga Banka Kombëtare Tregtare<sup>20</sup>, rezulton se në llogarinë bankare të djalit të subjektit të rivlerësimit, E. S., në monedhën lekë, janë kryer nga ky i fundit depozitime në cash, si më poshtë:
- Në datën 04.03.2011, janë depozituar likuiditete cash, në shumën 1.000.000 lekë, të cilat kanë kaluar nga banka, për periudhën 08.03.2011 - 17.01.2014, si bono thesari, dhe në datën 17.01.2014, janë transferuar sërish në llogarinë e E. S..
  - Në datën 17.01.2014, janë depozituar likuiditete cash, në shumën 1.000.000 lekë, të cilat së bashku me likuiditetet prej 1.000.000 lekësh, gjendje në llogarinë e E. S., në total në shumën prej 2.000.000 lekësh, kanë kaluar nga banka si obligacione 10-vjeçare, të emetuara më 24.01.2014.
  - Në datën 21.04.2014, janë depozituar likuiditete cash, në shumën 2.000.000 lekë, të cilat janë kaluar nga banka si obligacione 10-vjeçare, të emetuara më 25.04.2014.
  - Në datën 22.04.2014, janë depozituar likuiditete cash, në shumën 1.000.000 lekë, të cilat janë kaluar nga banka si obligacione 10-vjeçare, të emetuara më 25.04.2014.
- Në total, deri në fund të vitit 2014, përllorariten obligacione totale, në shumën 5.000.000 lekë.
- Në datën 15.03.2015, janë depozituar likuiditete cash, në shumën 4.500.000 lekë, nga të cilat shuma prej 1.600.000 lekësh është kaluar nga banka si obligacion 10-vjeçar, i emetuar më 23.04.2015 dhe shuma prej 3.000.000 lekësh, gjendje në llogarinë e E. S., kalon si obligacion 10-vjeçar, i emetuar më 24.07.2015.
100. Trupi gjykues konstatoi se shuma e likuiditeteve cash, e depozituar në llogari nga E. S., ka qenë 9.500.000 lekë, ndërsa shuma totale e obligacioneve të kaluara në bankë rezultoi në vlerën 9.600.000 lekë, ku, nga verifikimi i kryer nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, diferenca prej 100.000 lekësh<sup>21</sup> u konstatua të ketë rezultuar nga kalimi i interesave të përfituar nga obligacionet, në llogarinë e E. S..

---

<sup>19</sup> Në Kolegj, shuma prej 181.600 lekësh, e përlloratur më pak nga Komisioni, i takon diferencës së krijuar si pasojë e konvertimit të vlerës së transfertës nga monedha dollar në lek.

<sup>20</sup> Nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*}, datë 31.10.2019.

<sup>21</sup> Kalimi i interesave të përfituara nga obligacionet deri në datën 24.07.2015, data kur është kaluar shuma prej 3.000.000 lekësh për emetimin e obligacionit të ri 10-vjeçar.

101. Trupi gjykues, nga kontrolli i vendimit të Komisionit, vëren se, lidhur me krijimin e kësaj pasurie të llojit “likuiditet në formën e obligacioneve”, Komisioni, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së këtyre fondeve, ka arritur në konkluzionin se: *nga analiza financiare, duket se subjekti ka rezultuar me balancë negative për të përballuar shpenzimet dhe për të justifikuar kursimet cash dhe likuiditetet në bankë, si vijojnë: për vitin 2007, në shumën 691.358 lekë; për vitin 2008, në shumën 126.374 lekë; për vitin 2010, në shumën 112.730 lekë; për vitin 2011, në shumën 1.532.858 lekë; për vitin 2015, në shumën 564.010 lekë; për vitin 2016, në shumën 843.700 lekë (në total 3.871.028 lekë).*
102. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues vëren fillimisht se rezultatet financiare me mungesë të burimeve të ligjshme, të përlllogaritur nga Komisioni, për vitet 2015 dhe 2016, i përkasin shtesave të likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015 dhe 2016, dhe jo likuiditeteve *cash* të akumuluar për krijimin e obligacioneve deri në datën 24.07.2015. Në këto kushte, këto rezultate financiare janë pa efekt në analizën e kryer për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për të krijuar gjendje likuiditeti *cash* nga burime të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar investimin e kryer në obligacionet e thesarit, në shumën totale të sipërcituar prej 9.600.000 lekësh.
103. Nga kontrolli i analizës së likuiditetit “gjendje *cash*”, të krijuar ndër vite, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash* në fund të vitit 2007, në shumën 400.000 lekë, në fund të vitit 2008, në shumën 4.500.000 lekë, dhe në fund të vitit 2009 ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash*, në shumën 1.000.000 lekë (ndërkohë që ka deklaruar gjithashtu se gjatë të njëjtit vitit e ka pakësuar likuiditetin *cash* të akumuluar, në shumën e 4.526.610 lekëve).
104. Sipas rezultatit të analizës financiare të viteve të sipërcituara, të cilat kanë rezultuar me balanca negative, përkatësisht në shumën (-) 691.357 lekë, (-) 126.373 lekë dhe (-) 169.888 lekë, trupi gjykues vëren se kursimet në gjendje *cash* të justifikuar me burime të ligjshme, deri në fund të vitit 2009<sup>22</sup>, përlllogariten në shumën 677.129 lekë<sup>23</sup>. Në vijim, në fund të vitit 2011, subjekti rezulton të ketë deklaruar shtesë të kursimeve *cash*, në shumën 3.900.000 lekë, ndërkohë që gjatë të njëjtit vit ka deklaruar edhe pakësimin e likuiditeteve të akumuluar ndër vite, në shumën e 1.000.000 lekëve, të cilat i ka investuar në bono thesari. Referuar rezultatit të analizës financiare të këtij viti, i cili paraqitet me balancë negative, në shumën (-) 1.532.858 lekë, trupi gjykues vëren

---

<sup>22</sup>Kjo gjendje likuiditetesh *cash* mbartet deri në fund të vitit 2010 pasi subjekti nuk ka deklaruar shtesa të kursimeve në *cash* për këtë vit.

<sup>23</sup> Për vitin 2007, e gjithë shtesa e kursimeve *cash* rezulton me mungesë të plotë burimesh të ligjshme, për vitin 2008 përlllogaritet shuma prej 4.373.627 lekësh me burime të ligjshme (4.500.00 lekë – 126.373 lekë), për vitin 2009 për shtesën e kursimeve *cash* prej 1.000.000 lekësh dhe pakësimin e këtyre likuiditeteve, në shumën prej 4.526.610 lekësh përlllogaritet gjendje likuiditete *cash* në shumën 677.129 lekë, me burime të ligjshme (4.373.627 lekë + 1.000.000 lekë - 4.526.610 lekë - 169.888 lekë = 677.129 lekë)

se kursimet “gjendje *cash*”, të justifikuara me burime të ligjshme në fund të vitit, përlllogariten në shumën e 3.044.271 lekëve<sup>24</sup>.

105. Në fund të vitit 2012, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash*, në shumën 3.000.000 lekë, ndërkohë që deklaroi se gjatë vitit ka pakësuar nga likuiditeti *cash* i akumuluar, shumën prej 26.855 USD<sup>25</sup>. Nga verifikimet e kryera bazuar në rezultatin e analizës financiare për këtë vit me balancë pozitive, likuiditeti “gjendje *cash*”, i justifikuar me burime të ligjshme në fund të vitit 2012, përlllogaritet në shumën e 3.201.669 lekëve.
106. Në fund të vitit 2013, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash*, në shumën e 2.000.000 lekëve. Referuar rezultatit financiar të këtij viti me balancë pozitive, rezulton se likuiditeti “gjendje *cash*”, i justifikuar me burime të ligjshme në fund të vitit 2013, përlllogaritet në shumën e 5.201.669 lekëve.
107. Në fund të vitit 2014, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash*, në shumën e 2.300.000 lekëve, ndërkohë që, gjatë të njëjtit vit, ka deklaruar edhe pakësimin e likuiditeteve *cash* të akumuluar, në shumën e 4.000.000 lekë, për investim në obligacione të thesarit. Nga verifikimet e kryera bazuar në rezultatin e analizës financiare për këtë vit me balancë pozitive, likuiditeti “gjendje *cash*”, i justifikuar me burime të ligjshme, në fund të vitit 2014, pas investimit në obligacione, përlllogaritet në shumën e 3.501.669 lekëve.
108. Në vitin 2015, subjekti ka deklaruar se ka investuar në obligacione shumën prej 4.600.000 lekësh, ndërkohë që, në fund të vitit 2014, justifikonte me burime të ligjshme vetëm shumën prej 3.501.669 lekësh, e cila rezultoi e pamjaftueshme, në shumën 1.098.331 lekë, për të mbuluar investimin e kryer.
109. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues arrin në përfundimin se edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë rezultuar në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për krijimin pasurisë së llojit “obligacione”, të investuara nga personi i lidhur E. S. (djali i subjektit të rivlerësimit) pranë Bankës Tregtare Kombëtare, në vitet 2011, 2014 dhe 2015, në shumën totale prej 9.600.000 lekësh.
110. Në lidhje me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme të gjyshërve, për dhurimin e deklaruar, në shumën prej 15.000 USD, djalit të subjektit të rivlerësimit, S. S., me rastin e largimit në SHBA, duke pretenduar se prindërit e bashkëshortit të saj kanë pasur gjendje *cash* dhe llogari bankare të hershme, por për subjektin ka qenë e pamundur sigurimi i dokumentacionit përkatës, duke qenë se, sipas saj, babai i bashkëshortit ka ndërruar jetë në vitin 2016, ndërsa nëna e tij ka qenë shumë e sëmurë, në pamundësi për të shkuar në bankë. Sipas subjektit, banka nuk i vë në dispozicion këtë dokument asnjë personi tjetër qoftë edhe me prokurë. Subjekti ka pretenduar në ankimin e saj që *informacioni*

---

<sup>24</sup> Nga shuma e kursimeve *cash* të ligjshme në shumën 677.129 lekë, në vitin 2009, duke shtuar kursimet *cash* në vitin 2011, prej 3.900.000 lekësh, duke zbritur rezultatin financiar prej – 1.532.858 lekësh, mbeten kursime *cash* të ligjshme në shumën 3.044.271 lekë (677.129 lekë + 3.900.000 lekë – 1.532.858 lekë = 3.044.271 lekë).

<sup>25</sup> Konvertuar në shumën 2.842.602 lekë, me kursin zyrtar mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë.

*lidhur me sasinë e parave, të depozituara në emër të prindërve të bashkëshortit, kohën dhe lëvizjet e tyre të kërkohej nga ana e Kolegjit, në kuadër të kompetencave që i njeh ligji nr. 84/2016.*

111. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi kontrolloi aktet e fashikullit të hetimit të kryer nga Komisioni, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (djali i subjektit të rivlerësimit), nuk kanë dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues në lidhje me justifikimin e burimeve të ligjshme financiare të dhuruesve (prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit). Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni pranë bankave të nivelit të dytë, nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë në drejtim të sa më sipër.
112. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive për të dorëzuar dokumentacion justifikues lidhur me sa më sipër, duke kërkuar hetime nga ana e Kolegjit, lidhur me *sasinë e parave, të depozituara në emër të prindërve të bashkëshortit, kohën dhe lëvizjet e tyre*, trupi gjykues, bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të kësaj dispozite ligjore, për të vlerësuar se mosparaqitja e dokumentacionit justifikues bashkëlidhur me deklaratën e pasurisë *vetting* apo gjatë hetimit të kryer në Komision ishte për shkaqe të arsyeshme, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë para trupit gjykues përpjekjet e dështuara të saj për të siguruar informacionin e nevojshëm lidhur me të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortit të saj, të cilat ishin përdorur për dhurimin e deklaruar, në shumën 15.000 USD, djalit të subjektit të rivlerësimit, S. S., me rastin e largimit në SHBA. Rrjedhimisht, edhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit, për angazhimin e Kolegjit në hetime lidhur me këtë çështje, u gjet e pabazuar.
113. Trupi gjykues vlerësoi se, edhe nëse do të merreshin në konsideratë aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me lëvizjet bankare të llogarive në emër të vjehrrës së saj, znj. A. S., në cilësinë e provave të reja së bashku me parashtrimet, të cilat u vlerësuan se nuk kalojnë testin e pranueshmërisë, sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, përsëri ato nuk do të mund të përmbushnin barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të përdorura për dhurimin e shumës prej 15.000 USD, për sa kohë, referuar lëvizjeve të llogarisë në dollarë të znj. A. S., të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, në datën 22.09.2022, rezultoi se transferta e kryer nga znj. A. S. më 22.08.2014, në shumën 15.047,50 USD, në favor të S. S., kishte për burime fondet e derdhura *cash* në të njëjtën datë nga znj. A. S. në llogarinë e saj dhe jo gjendje kursimesh të saj ndër vite. Në këto kushte, justifikimi i ligjshmërisë së fondeve të përdorura për këtë dhurim do mund të kryhej vetëm në saje të një analize të ardhurash dhe shpenzimesh të znj. A. S., në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, analizë kjo që u pamundësua në saje të mosdepozitimit nga subjekti i rivlerësimit të dokumentacionit përkatës justifikues në lidhje me të ardhurat e ligjshme të përdorura.
114. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur S. S. (djali i subjektit të rivlerësimit) nuk kanë përmbushur detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të dhurimit të shumës prej 15.000 USD, të përfituar sipas transfertës bankare të datës 22.08.2014, në Raiffeisen Bank, me dërgues A. S. (vjehrra e subjektit të rivlerësimit).

115. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme, për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitet 2004, 2005, 2007, 2008, 2010, 2011, 2015 dhe 2016, respektivisht në shumat 6.462.230 lekë, 4.809.925 lekë, 691,357 lekë, 126.373 lekë, 112.729 lekë, 1.532.858 lekë, 564.010 lekë dhe 662.101 lekë, në total me balancë negative për gjithë periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, në shumën prej (-)14.961.583 lekësh.
116. Trupi gjykues vlerësoi se, edhe nëse do të merreshin në konsideratë aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me udhëtimet e punës, në cilësinë e provave të reja së bashku me parashtrimet, të cilat u vlerësuan se nuk kalojnë testin e pranueshmërisë, sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, rezultati i analizës financiare për periudhën e rivlerësimit do të përmirësohej me vetëm 433.529 lekë<sup>26</sup>, duke arritur në shumën prej (-)14.528.054 lekësh.
117. Në përfundim të analizës së kryer mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga kontrolli i ushtruar në Kolegj në lidhje me këtë kriter, subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, nuk arriti të përmbushë detyrimin kushtetues, të parashikuar nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj dhe të personave të lidhur me të, duke rezultuar, edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë objekt kontrolli, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të këtij kriteri, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

*D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

118. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të panevojshëm dhe kontradiktor arsyetimin e Komisionit për vlerësimin e kriterit të etikës, në lidhje me trajtimin e çështjes së mosparaqitjes së saj në detyrë pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë që nga data 1.4.2020. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga njëra anë, mosparaqitja e saj në detyrë konsiderohet si shkelje disiplinore, ndërsa nga ana tjetër, thuhet se kjo çështje është kompetencë e KLGj-së. Në këtë kontekst, subjekti pretendoi se, nëse kjo shkelje nuk ndikon në vendimmarrjen e Komisionit, sipas saj, nuk duhet të gjejë trajtim të gjerë në vendimin e Komisionit.
119. Lidhur me këtë pretendim të subjektit në ankim, trupi gjykues, pasi kontrolloi arsyetimin e Komisionit në vendimin e tij lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, konstatoi se ky i fundit është shprehur: *Komisioni, nga vlerësimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të shortuara, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor*

<sup>26</sup> Shumë kjo që u korrespondon shpenzimeve të kryera për udhëtime pune, sipas dokumentacionit të dorëzuar së bashku me parashtrimet në Kolegj.

*në raportin e tij, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional. [...] Trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të Grupit të Punës, nuk gjeti indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit. Komisioni vlerësoi të analizojë një element shumë të rëndësishëm, me të cilin është njohur gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit. Komisioni është informuar se subjektit të rivlerësimit i është dhënë nga KLD-ja, për arsye familjare, një leje 2-vjecare, nga 3 vjet që ka kërkuar, e cila ka përfunduar në datën 31.03.2020. Nga korrespondenca që Komisioni ka pasur me KLGj-në dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në detyrë që nga data e përfundimit të lejes 2-vjecare, nga data 1.4.2020 e në vijim. [...]. Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se mosparaqitja në detyrë e subjektit të rivlerësimit, pa shkaqe të arsyeshme dhe në mënyrë të pajustificuar, si dhe mosveprimi i saj për një periudhë 6 mujore duke mos u paraqitur në detyrën si gjyqtare e Gjykatës së Apelit, Tiranë është një shkelje disiplinore, në vijimësi. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua dokumentacion provues për të justifikuar pamundësinë objektive të paraqitjes në detyrë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin E të Kushtetutës. [...] Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk është paraqitur për të ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, që nga data 1.4.2020, si dhe nisur nga parashikimi ligjor për sa i përket periudhës së rivlerësimit, vlerëson se shkelja disiplinore lidhur me etikën, e ndodhur pas kësaj periudhe është kompetencë vlerësimi e KLGj-së. Në përfundim të këtij arsyetimi, Komisioni, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, arriti në konkluzionin se, nga hetimi i thellë i kryer, nuk u provuan indicie apo elementë që cenojnë figurën e gjyqtares Evjani Sinojmeri dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme për sa i përket periudhës së rivlerësimit.*

120. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me arsyetimin e Komisionit, për trajtimin në vendim të çështjes së konstatuar prej këtij të fundit mbi mosparaqitjen në detyrë të subjektit nga data 01.04.2020 deri në dhënien e këtij vendimi, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim nuk lidhet me vlerësimin përfundimtar të Komisionit dhe, rrjedhimisht, nuk ngrihet në nivelin e një shkaku ligjor për cenimin e vendimit të Komisionit sa i takon konkluzionit përfundimtar të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, as në drejtim të arsyetimit të vendimit lidhur me këtë kriter, i cili nuk u konstatua nga trupi gjykues që të jetë kontradiktor.
121. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mospërfshirje të kësaj çështjeje në arsyetimin e vendimit nga ana e Komisionit, për sa kohë vlerësimi i kësaj situate nuk futet në kompetencë të Komisionit, por të KLGj-së, çmohen nga trupi gjykues si të pabazuara. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që ky proces ka për qëllim rikthimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë dhe se transparenca e këtij procesi e procedurave të ndjekura nga Komisioni janë një element i rëndësishëm i këtij procesi, i vlerësuar ky në favor të interesit publik, aq më tepër kur situata e konstatuar nga Komisioni, si më sipër evidentuar, është ndërthurur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, duke ndikuar edhe në ecurinë e tij. Në këto kushte, trajtimi në vendim i natyrës së kësaj çështjeje dhe vlerësimit përfundimtar të saj nuk çmohet e pabazuar dhe e panevojshme, por, përkundrazi, e drejtë, e bazuar dhe e nevojshme.

122. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 378, datë 30.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 14.11.2024, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*